RAPORTI VJETOR 2015

BPB

Ne... i kemi rrënjët këtu,
e dijmë se si merr frymë ky vend,
traditën, vlerën e shtëpisë në trojet tona,
për çka na rreh zemra,
e dijmë çka i duhet familjës tonë dhe
çka ti pret nga jeta,
e dijmë, dhe jemi këtu,
që e jotja të mbetet e jotja,
se ne jemi,
Banka e vendit tënd

PËRMBAJTJA

4 Misioni dhe vizioni

6-7 Struktura organizative

8 Letra e kryetarit të bordit

10 Letra e kryeshefit ekzekutiv

12-13 Ribrendimi

16-17 Rezultatet afariste

20-22 Biznesi me klientë

23 Burimet njerëzore

26-27 Menaxhimi i riskut

28 Teknologjia informative

29 Menaxhimi i operacioneve

32 Përgjegjësia sociale e korporatës (CSR)

35-78 Raporti i audituesve të pavarur

MISIONI

Të jemi partner i besueshëm i klientëve në plotësimin e kërkesave financiare dhe mbështetës i sigurt në zhvillimin e gjithëmbarshëm të tyre.

VIZIONI

Vizioni i BPB-së është që të rritet në mënyrë të qëndrueshme, me qëllim të mbështetjes së individëve dhe bizneseve në zhvillimin e tyre ekonomik.

Brod, Dragash
©Arben Llapashtica

STRUKTURA ORGANIZATIVE




ASAMBLEJA E AKSIONARËVE
KËSHILLI I BURIMEVE NJERËZORE
KËSHILLI I RISKUT
KËSHILLI I AUDITIMIT
ZV. KRYESHEFI EKZEKUTIV
DIVIZIONI I OPERACIONEVE
DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE DHE ADMINISTRATËS
DIVIZIONI I ÇËSHTJEVE LIGJORE DHE PAJTUESHMËRISË
DIVIZIONI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM
SEKTORI KUNDËR SHPËRLARJES SË PARAVE (KSHP)

LETRA E KRYETARIT TË BORDIT

Kjo është letra ime e dytë si kryetar i bordit drejtues. Në letrën time të parë kam raportuar se viti 2014 ka qenë vit i sfidave. Viti 2015 ka qenë vit i ri-fokusimit.

Ekonomia botërore ka pasur zhvillim shumë të ngadalshëm. Kosova nuk ka qenë imune ndaj kësaj dhe ka pasur pak përmirësime në ekonomi kundrejt një mjedisi të pasigurisë politike. Për fat të mirë kompanitë në Kosovë në masë të madhe i janë përshtatur klimës biznesore.

BPB gjatë vitit 2015 është përqendruar në tregun e saj të synuar të klientëve individual dhe në bizneset e vogla dhe të mesme. Ky treg i mundëson bankës që t'i shfrytëzojë burimet e saja të kapitalit në mënyrën më efikase. Numri i klientëve është rritur dhe i ka mundësuar bankës që t'i diversifikoj rreziqet përgjatë një baze më të gjerë. Portfoliot e depozitave dhe kredive janë rritur në linjë me planin e biznesit për këtë vit.

Kthimet nga kreditë e këqija kanë qenë prioritet dhe shfrytëzimi i kompanive për arkëtimin e borxhit dhe përmbaruesve privat është dëshmuar mjaft i dobishëm.

Me lansimin e imazhit tonë të ri është shfrytëzuar mundësia që disa nga degët të zhvendosen në hapësira dhe lokacione më të përshtatshme dhe në të njëjtën kohë pamja jonë e re të përfshihet në të gjitha degët tona.

Optimizimi i kostove ka qenë një nga objektivat kryesore përgjatë gjithë vitit, qoftë përmes ri-negocimit të qirave të objekteve ose duke i kushtuar më shumë vëmendje kostove të ofruesve të jashtëm të shërbimeve. Gjithashtu, efiçienca e personelit është rritur dhe kjo ka ndikuar në mbajtjen stabile të numrit të personelit përkundër rritjes së biznesit. Në emër të Bordit, dëshiroj ta falënderoj personelin për entuziazmin me të cilin ata i'u kanë qasur të gjitha këtyre sfidave.

Rezultatet e bankës reflektojnë ndryshimet e shumta pozitive që kemi implementuar dhe për herë të parë banka ka gjeneruar fitim pas tatimit prej 2.0 milion euro bazuar në SNRF. Mbajtja e fitimit i ka mundësuar bankës që ta rris bazën e saj të kapitalit në 11.7 milion euro.

Në shkurt të vitit 2015, Banka Qendrore i ka miratuar anëtarët e bordit drejtues dhe që nga atëherë ne jemi takuar rregullisht në funksion mbikëqyrës.

Janë tri këshille të bordit – Këshilli i auditimit, riskut dhe burimeve njerëzore - dhe ato po ashtu kanë pasur takime në baza të rregullta. Dëshiroj ta falënderojë bordin për qasjen e tyre proaktive ndaj përgjegjësive të tyre.

Oliver Whittle
Kryetar i bordit drejtues

Oliver Whittle
Kryetar i bordit drejtues

LETRA E KRYESHEFIT EKZEKUTIV

Kam kënaqësinë të raportoj se viti 2015 ishte edhe një vit i suksesshëm për Bankën për Biznes (BPB). Banka ka vazhduar që të intensifikojë përqendrimin e saj në nevojat e klientëve, për të përmirësuar efikasitetin dhe për ta ngritur performancën financiare. Ngritja e performancës financiare në vitin 2015 është bazuar në të ardhura stabile, menaxhim efikas të kostove dhe nivele të ulëta të provizioneve për rreziqet e kredisë. E gjithë kjo është arritur në një treg që ka parë një konkurrencë të intensifikuar ndërmjet bankave.

BPB-ja ka përmbushur të gjitha kërkesat rregullative dhe ka pasur një performancë të mirë në vitin 2015. Ekuiteti i aksionarëve ishte 11.7 milion euro, përderisa kthimi në ekuitetin mesatar ka qenë 18.6%. Kreditë jo-performuese ishin 5.8% e që paraqet një nga normat më të ulëta në sektorin bankar vendor dhe rajonal.

Klientët tanë të çmuar pa dyshim kanë parë transformimin në brendim dhe pamje të re në lokacionet e degëve tona dhe në ofertat tona online. Ueb faqja jonë është ri-dizajnuar plotësisht dhe opsionet e ofrimit të shërbimeve tona përmes telefonit mobil dhe internetit janë ri-brenduar dhe avancuar. Rrjeti i degëve tona është standardizuar me një dizajn te ri qe pasqyron identitetin e bankës. Në disa qytete degët janë zhvendosur në hapësira të reja që janë më të përshtatshme për t'i plotësuar nevojat e klientëve tonë.

Dëshiroj t'i shpreh mirënjohje mbështetjes së vlefshme të ofruar nga Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC) së bashku me cilën BPB-ja ka punuar për të zhvilluar produkte të reja kreditore për t'i financuar projektet për efikasitet të energjisë për shtëpi dhe bizneset e vogla dhe të mesme.

Gjithashtu dëshiroj t'i shpreh mirënjohje rolit që ka luajtur Fondi Evropian për Evropën Juglindore (EFSE) i cili i ka ofruar BPB-së fonde afatmesme për huadhënie të mëtejshme për biznese mikro dhe të vogla dhe për bizneset rurale të angazhuara në bujqësi, blegtori dhe agro-përpunim.

Suksesi në vitin 2015 ka ardhur edhe si rezultat i përpjekjeve të kolegëve në të gjitha nivelet e bankës. Pa përpjekjet e tyre të pakursyera, nuk do të mund të arriheshin këto rezultate të jashtëzakonshme. Jam krenar që punoj me kolegë aq të devotshëm dhe i falënderoj për punën e palodhshme dhe angazhimin e tyre për BPB-në.

Si përfundim, dëshiroj t'i falënderoj klientët tanë për besimin dhe lojalitetin që vazhdojnë ta tregojnë ndaj BPB-së. Klientë të çmuar, si "banka e vendit tënd", jemi të zotuar që t'ju ofrojmë shërbime dhe produkte bankare me cilësinë më të lartë.

Richard Beasley
Kryeshef ekzekutiv

Richard Beasley
Kryeshef ekzekutiv

Richard Beasley

RIBRENDIMI

Nga data 1 qershor 2015, banka filloi të shfaq identitetin e saj me pamje të re. Inspirimi për logon vjen nga lulja "Gentiana Lutea" që është zbuluar nga mbreti ilir Genti.

Në logon e re mbizotëron ngjyra e portokalltë dhe gjethi i lulës të cilat së bashku paraqesin *optimizëm, ngrohtësi, rritje dhe siguri.*

Si pjesë e ribrendimit, në vend të emrit të plotë Banka për Biznes, identiteti i ri vizual çdoherë do të bazohet në përdorimin e akronimit BPB.

BpB BANKA PËR BIZNES

LOGO E VJETËR

Inspiruar nga lulja Gentiana Lutea,
e zbuluar nga mbreti ilir Genti

Formë unike e dy gjetheve
simetrike, strukturë që simbolizon
rritje, mbrojtje dhe rehati

Shkronja e parë e emrit
Banka për Biznes.

Simboli si kombinim me “B”
dhe formës së gjetheve

BPB

LOGO E RE

NE... I KEMI **RRËNJËT** KËTU

Ura e gurit, Gjakovë
©Arben Llapashtica

REZULTATET AFARISTE

Neto të hyrat nga interesi gjatë vitit 2015 ishin 7.5 milion euro (31 dhjetor 2014: 6.4 milion euro). Kjo kategori e të hyrave përfaqësoj rreth 76.8% të gjithsej të ardhurave bruto të BPB-së të realizuara gjatë vitit 2015 (31 dhjetor 2014: 74.9%).

Shpenzimet e interesit për vitin 2015 ishin 1.7 milion euro. Krahasuar me vitin 2014 kemi një ulje të shpenzimeve të interesit prej afër 887 mijë euro. Kjo rënie ishte për shkak të uljes së vazhdueshme të normave të interesit për depozita, edhe pse kishte rritje prej mbi 12.8 milion euro në vlerë të depozitave krahasuar me vitin 2014.

Përkundër faktit që portfolio neto kreditore në fund të vitit 2015 arriti shumën prej 87.0 milion euro, çka nënkupton një rritje prej 12.0 milion euro krahasuar me vitin 2014, provizionet neto për kredi dhe mjete tjera megjithatë kishin një trend stabil me një rritje të lehtë prej 218 mijë euro.

Shpenzimet operative në vitin 2015 ishin 5.3 milion euro, që përfaqësojnë një rritje prej 9.7% krahasuar me vitin 2014. BPB gjatë vitit 2015 arriti një profit neto prej 2.0 milion euro, ose 489 mijë euro me shumë se viti i kaluar apo shprehur në përqindje një rritje prej 32.3%.

Investimi në letra me vlerë të emetuara nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës gjatë vitit 2015 ka shënuar rritje prej afër 3.1milion euro, apo shprehur në përqindje një rritje prej 43.2%. Kjo rritje është për shkak të konsolidimit të tregut sekondar të letrave me vlerë, ku banka ka shprehur interes për investimet në këto instrumente financiare me qëllim të tregtimit tyre.

Sa i përket burimeve të fondeve, banka ka vazhduar përmirësimin e cilësisë së depozitave, duke u fokusuar në rritjen e depozitave me afat maturimi më të gjatë si dhe në ndryshimin e strukturës së tyre duke kaluar prej depozitave me afat të personave juridik tek ato të personave fizik, pasi që konsiderohen më të qëndrueshme dhe më stabile.

Gjatë vitit 2015 banka ka lidhur marrëveshje për kredi në vlerë prej 4.0 milion euro me EFSE. Nga kjo shumë, 3.0 milion euro janë arkëtuar gjate vitit 2015 dhe presim që edhe shuma prej 1.0 milion euro të arkëtohet gjate kuartalit te pare te vitit 2016. Ky fond do të përdoret për financimin e NVM-ve dhe zhvillimin e sektorit të agrobiznesit si dhe portfolios së kredive për energjinë efiçiente.

Në vitin 2015 është rrit kualiteti i portfolios kreditore, ku norma NPL (sipas rregulloreve të BQK-së) ka rënë në 5.8% nga 8.3% sa ishte në fund të vitit 2014. Po ashtu, edhe norma e mbulimit (coverage ratio), gjithmonë e kalkuluar sipas rregulloreve të BQK-së, ishte 103.8% në fund të vitit 2015, përderisa në fund të vitit 2014 ishte 92.6%.

REZULTATET AFARISTE
në mijëra



NE... E DIJMË **VLERËN E SHTËPISË** NË TROJET TONA

Lidhja e Prizrenit, Prizren

©Arben Llapashtica

BIZNESI ME KLIENTË

Gjatë vitit 2015, BPB ka zhvilluar aktivitete të ndryshme dhe ka qenë mjaft aktive në ofrimin e shërbimeve për sektorin e personave individualë (PI), sektorin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) si dhe sektorin e korporatave. Në sektorët PI dhe NVM fokusi ka qenë në rritjen dhe zhvillimin e shërbimeve enkas të dizajnuar për klientët e këtyre sektorëve. Në sektorin e korporatave qëllim ka qenë zhvillimi i mëtutjeshëm i portfolios kreditore, ruajtja e klientëve ekzistues dhe rritja e qarkullimit bankar e këtyre klientëve përmes BPB-së.

Krahasuar me vitin 2014, në vitin 2015 portfolio neto kreditore ka shënuar rritje prej 16%. Përderisa, depozitat e klientëve janë rritur për 12.5%. Krahas rritjës së portfolios në secilin sektor, ka pasur edhe një përmirësim të konsiderueshëm të kualitetit të portfolios kreditore.

Projektet e reja për efiçiencë të energjisë dhe agro kanë qenë prioritet për sektorin e PI dhe NVM. Të dy këto programe kanë rezultuar në një zhvillim të qëndrueshëm të portfolios kreditore. Banka ka përfituar një linjë kreditore nga EFSE për kreditë NVM dhe Agro, si dhe asistencë teknike nga IFC për efiçiencë të energjisë.

Shitja e tërthortë ka qenë një fokus shtesë i divizionit të biznesit me klientë. Përmes saj, banka synon të krijoj marrëdhënie të shëndosha dhe afatgjate me klientët.

Bashkëpunimi me klientët e korporatave, përveç në sferën e kreditimit, qarkullimit dhe depozitave, ka vazhduar edhe me marrëveshjeve të bashkëpunimit, ku BPB i'u ka ofruar klientëve të përbashkët kushte më të favorshme për blerjen e produkteve dhe shërbimeve të këtyre kompanive.

MENAXHIMI DHE ZHVILLIMI I PRODUKTEVE

Menaxhimi i produkteve dhe modifikimi i tyre sipas nevojës së klientëve, përkatësisht zhvillimeve në treg, ka qenë prioritet i BPB-së.

BPB, gjatë vitit 2015, ka ridizajnuar kartelat e kreditit dhe debitit. Janë zhvilluar produkte të reja si: kartelat për pensionistët, kartelat me këste dhe revolving. Të gjitha këto kartela pritet të lansohen në vitin 2016.

Në platformën e-banking janë shtuar veçoritë e sigurisë së transaksioneve dhe mundësitë për realizim të transaksioneve të shumëfishta por edhe të pagesave të ndryshme të brendshme dhe të jashtme.

Për të ngritur shfrytëzueshmërinë e produkteve dhe përforcuar marrëdhëniet me klientë, banka ka dizajnuar pakot bankare të cilat përmbajnë disa produkte dhe shërbime bankare. Këto pako i'u janë ofruar si personave individualë, ashtu edhe NVM-ve dhe korporatave.

SHËRBIMI PËR KLIENTË

BPB ka një rrjet të gjerë të degëve që u mundëson klientëve të saj të kenë qasje të shpejtë dhe të lehtë në produktet dhe shërbimet bankare. Viti 2015 ka qenë viti kur është bërë përditësimi i pamjes së të gjitha njësive të BPB-së për të reflektuar identitetin e ri të bankës.

Synimi i përhershëm i bankës është të krijojë dhe të mirëmbajë marrëdhënie të mira me klientët e saj duke përmirësuar mënyrën e shërbimit ndaj çdo klienti në të gjitha produktet dhe shërbimet.

Reagimi i shpejtë dhe profesional ndaj trajtimit të kërkesave të klientëve ka qenë kriter kryesor në rritjen e cilësisë së shërbimit. Trajtimi i sugjerimeve dhe ankesave të klientëve në mënyrë të shpejtë dhe profesionale ishte një formë e mbajtjes së klientëve të kënaqur.

Gjatë vitit 2015 është aktivizuar edhe qendra e thirrjeve, e cila ka kontaktuar shumë klientë, mirëpo edhe ka pranuar një numër të madh të thirrjeve nga ata. Kjo qendër ka ndikuar në ngritjen e cilësisë së shërbimit edhe për klientët që preferojnë këtë mënyrë të biznesit, respektivisht informimit.

BURIMET NJERËZORE

BPB e konsideron personelin element kyç në realizimin e synimeve të saj. Për këtë arsye banka i kushton rëndësi të madhe përzgjedhjes së personelit, zhvillimit të tyre dhe ambientit të punës. Si rezultat i ndryshimeve në organizimin e punëve, me qëllim të përmirësimit të proceseve, vitin 2015 e ka karakterizuar një proces i gjerë i rekrutimit, duke përfshirë si lëvizjet e personelit brenda institucionit ashtu edhe rekrutimin e personelit të ri nga jashtë.

Viti 2015 është karakterizuar po ashtu me trajnime intensive të personelit, duke përfshirë kryesisht personelin per shërbim ndaj klientëve si dhe nivelet e ndryshme të menaxhmentin të bankës. Fokusi i trajnimeve ka qenë në zhvillimin e aftësive të shërbimit dhe të shitjes, të cilat reflektohen në cilësinë e shërbimeve që BPB u ofron klientëve të saj, përderisa trajnimet e menaxhmentit kanë përfshirë fushat e rëndësishme për një menaxhim të suksesshëm dhe në linjë me trendet bashkëkohore të menaxhimit.

Janë mbajtur dy lloj trajnimesh të jashtme për personelin dhe katër module me tema të ndryshme për menaxhmentin. Janë mbajtur mbi 6500 orë trajnime nga trajnerë të jashtëm.
Ambienti dhe kushtet e punës janë ndër kriteret më të rëndësishme në motivimin e personelit dhe krijimin e raporteve afatgjata. Si përkushtim në realizimin e këtyre qëllimeve, BPB ka organizuar aktivitete të ndryshme të njohjes dhe shoqërimit të punëtorëve të saj, me qëllim të krijimit të raporteve të mira ndernjerëzore, të cilat shpresojmë të kontribuojnë edhe më tej në mbarëvajtjen e proceseve të punës.

Banka do të vazhdojë edhe gjatë vitit të ardhshëm me angazhimet e saja në investimin sa më të madh në zhvillimin dhe mirëqenien e personelit, në mënyrë që kjo të reflektohet edhe në plotësimin e nevojave të klientëve të saj.

Kalaja e Prizrenit
©Arben Llapashtica

NE... E DIJMË PËR ÇKA NA **RREH ZEMRA**

MENAXHIMI I RISKUT

MENAXHIMI I RISKUT KREDITOR

Ekspozimi ndaj riskut kreditor shfaqet si rrezik i humbjes financiare, që krijohet si pasojë e pamundësisë së kredimarrësit për të përmbushur të gjitha obligimet kreditore të kontraktuara ndaj bankës.

Menaxhimi i riskut kreditor është një proces që përfshin identifikimin e rreziqeve të mundshme, matjen e tyre, trajtimin e përshtatshëm dhe zbatimin e modeleve të duhura për minimizimin dhe menaxhimin e këtyre rreziqeve.

Viti 2015 është karakterizuar me konsolidimin dhe avancimin e shumë proceseve e aktiviteteve në menaxhimin e riskut kreditor si: procesi i vlerësimit dhe shqyrtimit të kërkesave kreditore, duke përfshirë këtu dhe procesin e shpërndarjes së kredive, monitorimin dhe kontrollet kreditore, infrastrukturën ligjore dhe rregullatore të aktivitetit kreditor, menaxhimin e kualitetit të portfolios kreditore, krijimin dhe rishikimin e modeleve statistikore, strukturave të avancuara të raportimit dhe analizave, procesin e kolektimit të borxheve të këqija dhe parandalimin e rasteve të reja të përkeqësimit të borxheve.

Menaxhmenti i bankës është i përkushtuar që të vazhdojë me rritjen e qëndrueshme dhe cilësore të portfolios kreditore.

PORTFOLIO E KREDIVE
në mijëra



MENAXHIMI I RISKUT OPERACIONAL

Risku operacional definohet si rrezik që vjen nga dështimi apo jo-adekuatshmëria e proceseve të brendshme në bankë, njerëzve apo sistemeve dhe/ose ngjarjeve të jashtme. Duke e marrë në konsideratë modelin e biznesit si dhe procesin e vendim-marrjes në bankë, menaxhimi i riskut operacional konsiderohet një faktor i rëndësishëm dhe pjesë përbërëse e menaxhimit të përgjithshëm të biznesit gjithnjë në përputhshmëri të plotë me principet e Bazel II dhe Rregullorës së Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK).

Banka bazohet në aplikimin e një game të gjerë të praktikave të shëndosha për menaxhimin e riskut operacional. BPB operon në një nivel të lartë të transparencës, përderisa ruan një diversitet të gjerë të produkteve dhe proceseve. Për me tepër, gjatë vitit 2015 banka ka ndërtuar sistemin e kontrolleve të brendshme dhe në këtë drejtim është ndërtuar komiteti i kontrolleve të brendshme, i cili njofton menaxhmentin e lartë si dhe bordin e drejtorëve mbi efektshmërinë e kontrolleve.

MENAXHIMI I RISKUT TË LIKUIDITETIT

BPB menaxhon rrezikun e likuiditetit përmes politikave dhe procedurave, të cilat janë në përputhje me rregulloren e BQK-së. Gjatë vitit 2015, banka ka menaxhuar likuiditetin duke arritur të mbaj nivelet e kërkuara në bazë të rregulloreve të BQK-së dhe ato te brendshme te bankës.

Banka ka bërë monitorimin e likuiditetit përmes indikatorëve të ndryshëm, duke qenë gjithmonë brenda limiteve të përcaktuara. Banka ka përpiluar projeksione të gjendjes së likuiditetit dhe ka avancuar modelet e stres testeve. Po ashtu, ka qenë aktive në tregun primar dhe sekondar të letrave me vlerë.

MENAXHIMI I RISKUT TË TREGUT

BPB ka mbajtur një nivel të ulët të ekspozimit ndaj valutave të huaja duke i shmangur pozicionet e hapura lëvizëse. Menaxhimi i riskut valutor bëhet në baza ditore duke monitoruar në mënyrë të vazhdueshme pozicionet dhe normat e këmbimit.

Menaxhimi i riskut të normës së interesit përfshin monitorimin e hendekut të maturitetit të mjeteve dhe detyrimeve që së bashku me rezultatet e stres testeve shërbejnë si paralajmërim i hershëm për ndikimet e lëvizjeve të normave të interesit në profitabilitetin e bankës. Banka, gjithashtu bën edhe matjen e vlerës neto ekonomike të kapitalit. Gjatë vitit 2015, banka ka qenë stabile ndaj lëvizjeve të normave të interesit në treg.

TEKNOLOGJIA INFORMATIVE

Divizioni i teknologjisë informative (TI-së) , ka realizuar projekte të rëndësishme të cilat kanë ndikuar pozitivisht në punën e përditshme të bankës. Përveç përditësimeve të sigurisë së sistemit me të cilin punojmë, divizioni i TI-së po ashtu ka bërë përditësime të sistemit që mundësojnë ofrimin e shërbimeve në mënyrë më të shpejtë dhe më kualitative.

Në vitin 2015 kemi bërë avancimin e rrjetit kompjuterik në zyrën qendrore si dhe kemi përforcuar kontrollin e trafikut të brendshëm kompjuterik. Ky avancim ka vazhduar edhe ne infrastrukturën e rrjetit kompjuterik për ndërlidhjen e degëve me zyrën qëndrore. Të gjitha këto kanë bërë që të kemi një sistem kompjuterik më efiçient dhe më të sigurt.

Projekti më i madh i divizionit të TI-së ka qenë avancimi i qendrës së rimëkëmbjes (Disaster Recovery Site - DRS). Ky sistem siguron vazhdimësinë e të gjitha shërbimeve që i ofron banka në raste të paraqitjes së gjendjes ose rrethanave të jashtëzakonshme nga shkaqet natyrore apo njerëzore.

MENAXHIMI I OPERACIONEVE

Menaxhimi i operacioneve është karakterizuar me zhvillime të rëndësishme që kanë rezultuar në përmirësimin e procesit të punës.

Administrimi i kredive, përmes përmirësimit të procesit të punës, ka vazhduar rritjen e efiçiencës në krahasim me vitet paraprake.

Banka ka vazhduar të realizojë pagesat ndërkombëtare dhe kombëtare si dhe garancionet bankare për klientët e saj. Në vitin 2015 është realizuar ndërlidhja e sistemit të bankës me Doganat e Kosovës. Ky projekt ka lehtësuar punën e klientëve duke shkurtuar kohën për realizimin e pagesave.

Aktiviteti i thesarit, në vitin 2015, ka qene i fokusuar ne menaxhimin e parasë se gatshme, plasmanëve, këmbime valutore dhe tregtimin e letrave me vlerë. Këto procese kane krijuar mundësi biznesore të suksesshme për BPB-në. Menaxhimi i llogarive në bankat korresponduese ka ndihmuar mbarëvajtjen e transaksioneve të pagesave nëpërmjet transfereve të jashtme dhe të brendshme

DEPOZITAT NË SHIFRA

në mijëra



NE... E DIJMË SE ÇKA I DUHET **FËMIJËVE TONË**

Buzëqeshjet# 1 Tetor

PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATËS (CSR)

BPB ka përkrahur aktivitete të ndryshme me anë të cilave ka mbështetur komunitetin ku vepron dhe punon. Këto aktivitete kishin në fokus grupet me të ndjeshme të shoqërisë.

Fillimisht banka ishte fokusuar që slogani "banka e vendit tënd" të kuptohet dhe të përjetohet nga vet personeli i saj, në mënyrë që më pas ta përcjellë domethënien e sloganit deri te klienti. Qe ky slogan të dëshmon edhe vërtetësinë e tij, banka ka përkrahur aktivitete të përgjegjësisë sociale me moton "ne e dimë çfarë i nevojitet një qytetari".

BANKA PËR BIZNES SH.A.

Pasqyrat financiare të përgatitura në përputhje me Standardet Ndërkombëtare
të Raportimit Financiar për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(së bashku me raportin e audituesve të pavarur)

Permbajtja **Faqe**

Raporti i Audituesve te Pavarur

Pasqyrat Financiare

Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe te Ardhurave Tjera Gjitheperfshirese	1
Pasqyra e Pozicionit Financiar	2
Pasqyra e Ndryshimeve ne Ekuitet	3
Pasqyra e Rrjedhes se Parase	4
Shenime per Pasqyrat Financiare	5-42

KPMG Albania Shpk Kosovo Branch
6, Pashko Vasa Street
Pristina, Kosovo

Telephone +381(38)246771
Telefax +381(38)610772
E-mail al-kosovo@kpmg.com
Internet www.kpmg.al

Raporti i Audituesve të Pavarur

Aksionarëve dhe Bordit të Drejtuesve të
Banka për Biznes Sh.a

Prishtinë, 31 mars 2016

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëngjitur të Banka për Biznes Sh.a ("Banka") të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2015, pasqyrat e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse, ndryshimeve në ekuitet dhe rrjedhjes së parasë për vitin e mbyllur në atë datë, dhe shënimet që përbëhen nga një përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për një kontroll të brendshëm i cili, të tillë siç drejtimi vendos se është i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Përgjegjësia e Audituesve

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Auditimi ynë u bë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të marrim një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare nuk kanë anomali materiale.

Auditimi ka të bëjë me kryerjen e procedurave për të marrë evidencë auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi ynë, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Kur vlerësojmë këto rreziqe, ne marrim në konsideratë kontrollin e brendshëm të entitetit mbi përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare në mënyrë që të planifikojmë procedura të përshtatshme auditimi në rrethanat përkatëse të entitetit, por jo me qëllim që të shprehim një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së metodave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërisë së çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.

Opinion

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të sinqertë, në të gjitha aspektet materiale, gjendjen financiare të Bankës më 31 dhjetor 2015, rezultatin e saj financiar dhe rrjedhjen e parave për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

KPMG Albania Shpk Kosovo Branch

KPMG Albania Shpk Kosovo Branch
6, Pashko Vasa Street,
Pristina, Kosovo

KPMG Albania Shpk Kosovo Branch, a branch of KPMG Albania Shpk, an Albanian limited liability company and a member firm of the KPMG network of independent member firms affiliated with KPMG International Cooperative ("KPMG International"), a Swiss entity.

Registered with the Kosovo Business Registration Agency with Business no. 70291840

Banka per Biznes Sh.a.

Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe te Ardhurave te Tjera Gjitheperfshirese

Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015

Ne mije EUR	Shenime	2015	2014
Te ardhurat nga interesi	6	9,173	9,013
Shpenzimet e interesit	6	(1,669)	(2,556)
Te ardhurat neto nga interesi		**7,504**	**6,457**
Te ardhurat nga tarifa dhe komisionet	7	1,848	1,999
Shpenzimet nga tarifa dhe komisionet	7	(414)	(399)
Te ardhurat neto nga tarifa dhe komisionet		**1,434**	**1,600**
Kthimet e kredive te fshira me heret		542	465
Fitimi neto nga kembimi valuator		70	25
Te ardhurat nga shitja e letrave me vlere		120	-
Te ardhurat e tjera operative		100	69
Gjithsej te ardhurat operative		**9,770**	**8,616**
Humbje nga zhvleresimet e kredive	15	(1,584)	(2,059)
Kthimi i provizionit per kerkesat ndaj garancive		19	6
Ulja e vleres se pasurive te riposeduara	16	(305)	(241)
Provizione te tjera	23	(642)	-
Shpenzime te tjera operative	8	(5,257)	(4,793)
Gjithsej shpenzimet operative		**(7,769)**	**(7,087)**
Fitimi para tatimit		**2,001**	**1,529**
Shpenzimet e tatimit ne fitim	9	-	(17)
Fitimi neto per vitin		**2,001**	**1,512**
Te ardhurat e Tjera Gjitheperfshirese			
Zerat qe jane ose mund te riklasifikohen ne fitim ose humbje			
Rezerva per vleren e drejte (asetet financiare per shitje)		**(18)**	**-**
Gjithsej te ardhurat gjitheperfshirese per vitin		**1,983**	**1,512**

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe te ardhurave tjera gjitheperfshirese duhet te lexohet se bashku me shenimet e shpalosura nga faqja 5 deri ne faqen 42, te cilat jane pjese perberese te ketyre pasqyrave financiare.

Banka per Biznes Sh.a.
Pasqyra e Pozicionit Financiar
Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015

Ne mije EUR	Shenim	2015	2014
Aktivet			
Paraja e gatshme dhe ne banka	10	10,623	8,540
Gjendja me Banken Qendrore te Kosoves	11	22,576	20,891
Kredi dhe paradhenie per bankat	12	960	1,211
Investime te mbajtura deri ne maturitet	13	-	7,242
Aktive financiare te vlefshme per shitje ('VPS')	14	10,372	-
Kredi dhe paradhenie per klientet	15	87,025	74,979
Pasuri te riposeduara	16	747	843
Aktive te tjera financiare	17	291	459
Aktive te tjera	18	122	249
Aktive te patrupezuara	19	147	145
Prona dhe pajisje	20	1,041	642
Gjithsej aktive		**133,904**	**115,201**
Detyrimet			
Detyrime ndaj klienteve	21	115,848	103,003
Detyrime te varura	22	1,848	1,848
Huamarrje	22	3,017	-
Detyrim per tatimin e shtyre	9	105	105
Detyrime te tjera dhe provizione	23	1,345	487
Gjithsej detyrime		**122,163**	**105,443**
Ekuiteti			
Kapitali aksionar	24	11,247	11,247
Rezerva te tjera	24	857	857
Rezerva per rivleresim	24	96	96
Rezerva per vleren e drejte		(18)	-
Humbjet e akumuluara		(441)	(2,442)
Gjithsej ekuiteti		**11,741**	**9,758**
Gjithsej detyrime dhe ekuiteti		**133,904**	**115,201**

Keto pasqyra financiare jane miratuar nga menaxhmenti i Bankes me 31 mars 2016 dhe nenshkruar ne emer te tyre nga:

Richard Beasley
Kryeshef Ekzekutiv

Avni Berisha
Udheheqes i Divizionit te Financave

Pasqyra e pozicionit financiar duhet te lexohet se bashku me shenimet e shpalosura nga faqja 5 deri ne faqen 42, te cilat jane pjese perberese te ketyre pasqyrave financiare.

Banka per Biznes Sh.a.
Pasqyra e Ndryshimeve ne Ekuitet
Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015

Ne mije EUR	Kapitali aksionar	Rezerva te tjera	Rezerva per rivleresim	Humbjet e akumuluara	Rezerva per vleren e drejte	Gjithsej
Gjendja me 1 janar 2014	**11,247**	**857**	**-**	**(3,954)**	**-**	**8,150**
Transaksionet me aksionaret e Bankes	**-**	**-**	**-**	**-**	**-**	**-**
Gjithsej te ardhurat gjitheperfshirese						
Rezerva per rivleresim	-		-	-	-	-
Fitimi i vitit	-	-	-	1,512	-	1,512
Te ardhurat tjera gjitheperfshirese	-	-	96		-	96
Gjithsej te ardhurat gjitheperfshirese	**-**	**-**	**96**	**1,512**	**-**	**1,608**
Gjendja me 31 dhjetor 2014	**11,247**	**857**	**96**	**(2,442)**	**-**	**9,758**
Gjendja me 1 janar 2015	**11,247**	**857**	**96**	**(2,442)**	**-**	**9,758**
Transaksione me aksionaret e Bankes						
Gjithsej te ardhurat gjitheperfshirese						
Fitimi i vitit	-	-	-	2,001	-	**2,001**
Humbje te tjera gjitheperfshirese (rezerva e vleres se drejte)	-	-	-	-	(18)	**(18)**
Gjithsej te ardhurat/(humbje) gjitheperfshirese	**-**	**-**	**-**	**2,001**	**(18)**	**1,983**
Gjendja me 31 dhjetor 2015	**11,247**	**857**	**96**	**(441)**	**(18)**	**11,741**

Pasqyra e ndryshimeve ne ekuitet duhet te lexohet se bashku me shenimet e shpalosura ne faqet 5 deri ne faqen 42, te cilat jane pjese perberese e ketyre pasqyrave financiare.

Banka per Biznes Sh.a.
Pasqyra e Rrjedhjes se Parase
Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015

Ne mije EUR	**Shenime**	**2015**	**2014**
Rrjedhja e parase nga aktivitetet operative			
Fitimi i vitit		2,001	1,512
Zerat jo-ne para te gatshme ne pasqyra financiare:			
Zhvleresimi	20	281	271
Amortizimi	19	87	109
Ftimi nga shitja e pronave dhe pajisjeve		(30)	(87)
Shpenzimet per humbjet e kredive	15	1,584	2,059
Renia e vleres per pasurite e riposeduara	16	305	241
Shpenzimet e interesit	6	1,669	2,556
Te ardhurat nga interesi	6	(9,173)	(9,013)
		(3,276)	**(2,352)**
Ndryshimet ne:			
Kredi dhe paradhenie per bankat	12	251	(845)
Kredi dhe paradhenie per klientet	15	(13,599)	(8,933)
Rezerva e detyrueshme ne BQK	11	(1,066)	(221)
Aktive te tjera	18	127	(591)
Detyrim per tatimin e shtyre		-	17
Aktive te tjera financiare	17	168	-
Pasuri te riposeduara	16	(209)	146
Detyrime ndaj klienteve	21	13,049	2,187
Detyrime te tjera dhe provizione	23	858	(2,091)
Interesi i arketuar		9,142	9,013
Interesi i paguar		(1,873)	(2,556)
Paraja neto nga/ (shfrytezuar ne) aktivitetet operative		**3,572**	**(6,226)**
Rrjedhja e parase nga aktivitetet investuese			
Investimet ne aktive financiare te vlefshme per shitje	14	(10,390)	-
Te hyra nga shitjet e investimeve te mbajtura per shitje	13	7,242	8,806
Blerja e pronave dhe pajisjeve	20	(711)	(159)
Blerja e aktiveve te patrupezuara	19	(89)	(7)
Te hyra nga shitjet e pronave dhe pajisjeve		61	127
Paraja neto e (perdorur)/ gjeneruar nga aktivitetet investuese		**(3,887)**	**8,767**
Rrjedhja e parase nga aktivitetet financuese			
Te hyra nga huamarrjet	22	3,017	-
Paraja neto nga aktivitetet financuese		**3,017**	**-**
Rritja neto e parase dhe ekuivalenteve te saj		**2,702**	**2,541**
Paraja e gatshme dhe ekuivalentet e saj ne fillim te vitit	10	**21,452**	**18,911**
Paraja e gatshme dhe ekuivalentet e saj ne fund te vitit	10	**24,154**	**21,452**

Pasqyra e rrjedhjes se parase duhet te lexohet se bashku me shenimet e shpalosura nga faqja 5 deri ne faqen 42, te cilat jane pjese perberese te ketyre pasqyrave financiare.

Banka per Biznes Sh.a.
Shenimet per Pasqyrat Financiare
Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015
(Shumat jane ne mije EUR, pervec nese shprehet ndryshe)

1. Hyrje

Banka Private e Biznesit Sh.a ka marre licencen per aktivitete bankare me 29 mars 2001, dhe ka filluar aktivitetin me 24 prill 2001.

Bazuar ne vendimin e Bordit te Drejtoreve te dates 28 shkurt 2005, dhe pas miratimit final nga Banka Qendrore e Kosoves ("BQK") me date 22 mars 2005, Banka ka ndryshuar emrin nga Banka Private e Biznesit ne Banka per Biznes ("Banka"). Ne vitin 2006, Banka eshte regjistruar si shoqeri aksionare ("Sh.a"). Banka operon si nje banke komerciale dhe e kursimeve per te gjitha kategorite e konsumatoreve brenda Kosoves nepermjet rrjetit te 7 degeve te saj ne Prishtine, Gjakove, Peje, Prizren, Ferizaj, Mitrovice dhe Gjilan dhe 19 nendege te vendosura ne Kosove (2014: 20).

2. Bazat e pergatitjes

(a) Pasqyra e pajtueshmerise

Keto pasqyra financiare jane pergatitur ne perputhje me Standardet Nderkombetare te Raportimit Financiar (SNRF) te leshuara nga Bordi per Standarde Nderkombetare te Kontabilitetit (BSNK).

(b) Bazat e pergatitjes

Keto pasqyra financiare jane pergatitur mbi bazen e kostos historike, pervec aktiveve financiare te vlefshme per shitje, te cilat jane matur me vleren e drejte.

(c) Monedha funksionale dhe raportuese

Keto pasqyra financiare jane paraqitur ne Euro ('EUR') e cila eshte monedha funksionale e Bankes. Te gjitha shumat jane rrumbullakuar ne mijeshen me te afert, pervec kur ceket ndryshe.

(d) Perdorimi i gjykimeve dhe i vleresimeve

Ne pergatitjen e ketyre pasqyrave financiare, manaxhmenti ka bere gykime, vleresime dhe supozime qe ndikojne ne zbatimin e politikave kontabel te Bankes dhe mbi shumat e raportuara te aktiveve, detyrimeve, te ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund te kene ndryshim nga keto vleresime.

Vleresimet dhe supozimet rishikohen ne menyre te vazhdueshme. Rishikimet e vleresimeve njihen ne menyre prospektive.

Informacionet mbi elementet e rendesishem me pasiguri ne vleresime dhe mbi gjykimet kritike ne zbatimin e politikave kontabel me efekt te konsiderueshem ne vlerat kontabel ne pasqyrat financiare, jane pershkruar ne shenimet 4, 5 dhe 26.

3. Politika te rendesishme te kontabilitetit

Politikat e kontabilitetit te paraqitura me poshte jane aplikuar ne menyre konsistente ne te gjitha periudhat e paraqitura ne keto pasqyra financiare.

(a) Interesi

Te ardhurat dhe shpenzimet nga interesi njihen ne fitim ose humbje me metoden e interesit efektiv. Norma e interesit efektiv eshte norma qe ben aktualizimin e flukseve te pagesave dhe arketimeve te pritshme ne te ardhmen gjate jetegjatesise se pritshme te aktivit ose detyrimit financiar (ose sipas rastit mund te jete nje periudhe me e shkurter) deri ne shumen e mbartur te aktivit ose detyrimit financiar. Gjate llogaritjes se normes efektive te interesit, Banka vlereson flukset monetare te ardhshme duke marre parasysh te gjitha kushtet kontraktuale te instrumentit financiar, por jo humbjet e ardhshme te kredise.

Llogaritja e normes efektive te interesit perfshin te gjitha kostot e transaksionit dhe komisionet e zbritjet e tjera te paguara ose pranuara, te cilat jane pjese integrale e normes se interesit efektiv. Kostot e transaksionit perfshijne kostot shtese qe jane direkt te lidhura me blerjen apo emetimin e nje aktivi apo detyrimi financiar.

Te ardhurat dhe shpenzimet nga interesi te paraqitura ne pasqyren e fitimit ose humbjes dhe te Ardhurave te Tjera Gjitheperfshirese (ATGj) perfshijne:

- Interesa nga aktive ose detyrime financiare matur me koston e amortizuar te llogaritur mbi bazen e interesit efektiv; dhe
- Interesa nga investime te vlefshme per shitje te llogaritura mbi bazen e interesit efektiv.

Banka per Biznes Sh.a.
Shenimet per Pasqyrat Financiare
Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015
(Shumat jane ne mije EUR, pervec nese shprehet ndryshe)

3. Politika te rendesishme te kontabilitetit (vazhdim)

(b) Tarifa dhe komisione

Te ardhurat dhe shpenzimet per tarifat dhe komisionet te cilat jane pjese perberese e normes efektive te interesit ne nje aktiv ose detyrim financiar, perfshihen ne matjen e normes se interesit efektiv.

Te ardhurat e tjera nga tarifat dhe komisionet, perfshire edhe tarifat e sherbimeve te llogarive, tarifat e transferimit te fondeve, komisione shitjesh dhe tarifa per vendosje me afat ne banka njihen me kryerjen e sherbimeve te lidhura me to. Kur nje angazhim per kreditim nuk pritet te rezultoje ne terheqjen te kredise, komisionet e kredise perkatese, njihen ne baze lineare pergjate periudhes se ngazhimit.

Shpenzimet e tjera per tarifa dhe komisione lidhen kryesisht me komisione per transaksione dhe sherbime, te cilat regjistrohen si shpenzim ne momentin e pranimit te sherbimit.

(c) Pagesat e qirase

Pagesat per qirane operative njihen ne fitim ose humbje ne baze lineare pergjate afatit te qirase. Zbritjet nga qiraja njihen si pjese perberese e totalit te shpenzimeve per qira, pergjate afatit te qirase.

(d) Shpenzimet e tatimit

Shpenzimet e tatimit perfshijne tatimin aktual dhe te shtyre. Tatimi aktual dhe tatimi i shtyre njihen ne pasqyren e fitimit ose humbjes te periudhes me perjashtim te rasteve qe lidhen me zera qe njihen direkt ne ekuitet ose ne pasqyren e te ardhurave te tjera gjitheperfshirese.

(i) Tatimi aktual

Tatimi aktual perfshin tatimin qe pritet te paguhet ose arketohet per te ardhurat e tatueshme ase humbjet per periudhen, duke perdorur normat ne fuqi ne daten e raportimit, dhe cdo rregullim te tatimit qe duhet te paguhet ose te arketohet ne lidhje me vitet e meparshme

(ii) Tatimi i shtyre

Tatimi i shtyre njihet mbi diferencat e perkohshme qe dalin midis bazes tatimore dhe vleres kontabel neto te aktiveve dhe detyrimeve ne pasqyra financiare. Tatimi i shtyre nuk njihet per diferencat e perkohshme qe lindin ne momentin e njohjes fillestare te aktiveve ose detyrimeve te transaksioneve qe nuk perbejne nje kombinim biznesi dhe qe nuk ndikon as fitimin/humbjen kontabel dhe as ate te tatueshme.

Matja e tatimit te shtyre reflekton pasojat tatimore qe do ta percillnin menyren ne te cilen banka pret ne fund te periudhes raportuese qe te mbuloje apo vendose vleren kontabel te mjeteve dhe detyrimeve te saj.

Tatimi i shtyre matet sipas normave tatimore qe priten te aplikohen ne diferencat e perkoheshme kur ato kthehen, permes normave tatimore ne fuqi ne daten e raportimit.

Mjetet dhe detyrimet tatimore te shtyra kompensohen ndermjet tyre nese ka nje te drejte ligjore per ta kompensuar me mjetin dhe detyrimin e tatimit dhe kur nderlidhen me tatimet e pagueshme kundrejt autoritetit te njejte tatimor. Tatimet shtese qe vijne si rezultat i shperndarjes se dividendes nga ana e bankes njihen ne te njejten kohe kur edhe njihen detyrimet per ta paguar dividentin respektiv.

Nje aktiv tatimor i shtyre njihet per humbjet sipas tatimeve, krediteve tatimore dhe dallimet e perkoheshme te zbriteshme te pashfrytezuara, vetem ne ate mase qe eshte e mundur te shfrytezohet per fitimet e ardhshme te tatueshme kunder te cilave mund te shfrytezohet ky aktiv. Aktivet e tatimit te shtyre rishikohen ne secilen date te raportimit dhe reduktohen ne ate mase qe nuk eshte me e mundur qe perfitimet nga tatimi te realizohen.

(iii) Ekspozimet tatimore

Ne percaktimin e shumes se tatimit aktual dhe te shtyre, Banka merr parasysh ndikimin e pozicioneve tatimore te pasigurta dhe nese tatimi apo interesat shtese mund te jene te pagueshme. Ky vleresim mbeshtetet ne vleresime dhe supozime dhe mund te perfshije nje sere gjykimesh ne lidhje me ngjarjet e ardhshme. Informacione te reja mund te behen te disponueshme dhe te bejne qe Banka te ndryshoje vendimin e saj ne lidhje me pershtatshmerine e detyrimeve tatimore ekzistuese; keto ndryshime ne detyrimet tatimore do te ndikojne shpenzimet tatimore ne periudhen ne te cilen eshte bere nje percaktim i tille.

Banka per Biznes Sh.a.
Shenimet per Pasqyrat Financiare
Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015
(Shumat jane ne mije EUR, pervec nese shprehet ndryshe)

3. Politikat e rendesishme te kontabilitetit (vazhdim)

(e) Transaksionet ne monedhe te huaj

Transaksionet ne monedhe te huaj rivleresohen ne monedhen funksionale perkatese te Bankes ne kursin e kembimit ne daten e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet ne monedhe te huaj ne daten e raportimit konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te normes se kembimit ne po ate date.

Fitimi ose humbja nga zerat monetare eshte diferenca ndermjet kostove te amortizuara ne monedhen funksionale ne fillim te periudhes, e rregulluar per interesin efektiv dhe pagesat gjate periudhes, dhe kostos se amortizuar ne monedhe te huaj me kursin e kembimit ne fundin e vitit.

Aktivet dhe detyrimet jo-monetare ne monedhe te huaj qe maten me vleren e drejte jane konvertuar ne monedhen funksionale me kursin e kembimit ne daten kur eshte percaktuar vlera e drejte. Zerat jo-monetare qe maten ne baze te kostos historike ne monedhe te huaj, konvertohen duke perdorur kursin e kembimit ne daten e transaksionit. Diferencat qe lindin nga rivleresimi njihen ne fitim ose humbje.

(f) Aktivet financiare dhe detyrimet financiare

(i) Njohja

Banka fillimisht njeh kredite dhe paradheniet, investimet e mbajtura deri ne maturitet dhe te vlefshme per shitje, depozitat dhe huamarrjet dhe borxhet e varura ne daten qe ato jane krijuar. Blerjet dhe shitjet e aktiveve financiare njihen ne daten e tregtimit ne te cilen Banka angazhohet per te blere ose shitur aktivin. Te gjitha aktivet dhe detyrimet e tjera financiare njihen fillimisht ne daten e tregtimit, e cila eshte data kur Banka behet pale ne kushtet kontraktuale te instrumentit.

Nje aktiv ose detyrim financiar fillimisht matet me vleren e drejte plus kostot e transaksionit qe lidhen drejtperdrejt me blerjen apo leshimin e tij.

(ii) Klasifikimi

Aktivet financiare

Banka klasifikon aktivet e saj financiare ne nje nga kategorite e meposhtme:

- Hua dhe llogari te arketueshme;
- Te mbajtura deri ne maturitet.
- Mjete financiare te vlefshme per shitje

Shiko shenimet 3.(g), (h), (i) dhe (j).

Detyrimet financiare

Banka klasifikon detyrimet e saj financiare si te matura me kosto te amortizuar. Shih shenimin 3.(k).

(iii) Çregjistrimi

Aktivet financiare

Banka çregjistron nje aktiv financiar kur mbarojne te drejtat kontraktuale per rrjedhjet e parave nga aktivi financiar, ose transferon te drejtat per te marre rrjedhje te paave kontraktuale ne nje transaksion ne te cilin kryesisht te gjitha rreziqet dhe perfitimet e pronesise se aktivit financiar jane transferuar ose ne te cilat Banka as nuk transferon e as nuk ruan ne thelb te gjitha rreziqet dhe perfitimet e pronesise dhe nuk mban kontrollin e aktivit financiar. Cdo interes ne aktivet financiare te transferuara qe kualifikohen per çregjistrim qe eshte krijuar apo mbajtur nga Banka njihet si nje aktiv ose detyrim me vete.

Ne momentin e çregjistrimit te nje aktivi financiar, diferenca midis vleres kontabel neto te aktivit (ose vlera kontabel qe i perket pjeses se aktivit te transferuar), dhe totalit te (i) konsiderates se marre (perfshire çdo aktiv te ri te perfituar ose detyrim te presupozuar) dhe (ii) cdo fitimi ose humbje te akumuluara qe eshte njohur ne te ardhura te tjera gjitheperfshirese, njihet ne fitim ose humbje.

Detyrimet financiare

Banka çregjistron nje detyrim financiar kur obligimet kontraktuale shlyhen, anulohen ose kane perfunduar.

Banka per Biznes Sh.a.
Shenimet per Pasqyrat Financiare
Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015
(Shumat jane ne mije EUR, pervec nese shprehet ndryshe)

3. Politikat e rendesishme te kontabilitetit (vazhdim)

(f) Aktivet financiare dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(iv) Kompensimi

Aktivet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe shuma neto paraqitet ne pasqyren e pozicionit financiar, atehere, dhe vetem atehere kur Banka ka te drejten ligjore per te kompensuar shumat dhe ajo synon ose te shlyeje ato ne nje baze neto, ose te realizoje aktivin dhe te shlyeje detyrimin njekohesisht.

Te ardhurat dhe shpenzimet paraqiten ne baze neto vetem atehere kur lejohet sipas SNRF, apo per fitimet dhe humbjet qe vijne nga nje grup i transaksioneve te ngjashme sikurse nga aktiviteti tregtar i Bankes.

(v) Matja me kosto te amortizuar

Kosto e amortizuar e nje aktivi ose detyrimi financiar eshte vlera me te cilen aktivi ose detyrimi financiar matet ne njohjen fillestare, minus shlyerjet e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke perdorur metoden e interesit efektiv per cdo diference ndermjet vleres fillestare te njohur dhe vleres ne maturim, minus cdo zbritje per efekt zhvleresimi.

(vi) Matja e vleres se drejte

'Vlera e drejte' eshte çmimi me te cilin aktivi mund te shitet, ose nje pasivi te transferohet, ne nje transaksion te zakonshem mes pjesemarresve ne treg ne daten e matjes, ne nje treg primar ose ne mungese te tij, ne tregun me te favorshem ku Banka ka qasje ne ate date. Vlera e drejte e nje detyrimi pasqyron rrezikun e mosekzekutimit te tij. Kur eshte e mundur, Banka mat vleren e drejte te nje instrumenti duke perdorur çmimin e kuotuar ne treg aktiv per instrumentin. Tregu quhet aktiv kur transaksionet lidhur me aktivin apo detyrimin ndodhin shume shpesh dhe me volum te mjaftueshem per te siguruar informacion te vazhdueshem per çmimin.

Kur nuk ekziston nje çmim i kuotuar ne nje treg aktiv Banka perdor teknika vleresimi qe maksimizojne perdorimin e inputeve te vezhgueshme dhe minimizojne perdorimin e inputeve jo te vezhgueshme. Teknika e zgjedhur e vleresimit perfshin gjithe faktoret qe pjesemarresit ne treg do te konsideronin ne vendosjen e çmimit te nje transaksioni.

Evidenca me e mire e vleres se drejte te nje instrumenti financiar me njohjen fillestare te tij eshte zakonisht çmimi i transaksionit - pershembull vlera e drejte e konsiderates se dhene ose te marre. Nese Banka vendos se vlera e drejte ne njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit dhe se vlera e drejte nuk eshte evidentuar as me nje çmim te kuotuar ne nje treg aktiv per nje aktiv ose detyrim identik, e as nuk eshte e bazuar ne nje teknike vleresimi qe perdor vetem te dhena nga tregjet te vrojtueshme ne treg, atehere instrumenti financiar matet fillimisht me vleren e drejte, rregulluar per te shtyre ne kohe diferencen midis vleres se drejte ne njohjen fillestare dhe çmimit te transaksionit. Me pas, kjo diference eshte njohur ne fitim ose humbje ne nje baze te pershtatshme mbi jeten e instrumentit, por jo me vone se vleresimi qe mbeshtetet plotesisht nga te dhena te vezhgueshme te tregut ose kur transaksioni mbyllet.

Nese nje aktiv ose pasiv i matur me vleren e drejte ka çmim te ofruar dhe çmim te kerkuar, Banka mat aktivet dhe pozicionet e gjata me çmimin e ofruar dhe detyrimet dhe pozicionet e shkurtra me çmim te kerkuar.

Vlera e drejte e nje depozite pa afat nuk eshte me e vogel se shuma qe paguhet ne momentin e kerkeses, e cila zbritet nga data e pare kur do te kerkohej pagesa e depozites.

Banka njeh transferimet midis niveleve te hierarkise se vleres se drejte deri ne fund te periudhes raportuese gjate se ciles ky ndryshim ka ndodhur.

Banka per Biznes Sh.a.
Shenimet per Pasqyrat Financiare
Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015
(Shumat jane ne mije EUR, pervec nese shprehet ndryshe)

3. Politikat e rendesishme te kontabilitetit (vazhdim)

(f) Aktivet financiare dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(vii) Identifikimi dhe matja e zhvleresimit

Zhvleresimi i huave dhe paradhenieve

Ne çdo date raportimi, Banka vlereson nese ka evidence objektive qe aktivet financiare, te cilat nuk mbahen me vleren e drejte nepermjet fitimit ose humbjes, jane zhvleresuar. Nje aktiv financiar ose nje grup aktivesh financiare eshte zhvleresuar kur evidenca objektive demonstrojne se nje ngjarje qe sjell humbje ka ndodhur pas njohjes fillestare te aktivit dhe qe ngjarja qe sjell humbje ka nje ndikim ne flukset e ardhshme monetare te aktivit ose grupeve te aktiveve dhe qe mund te vleresohet me besueshmeri.

Evidenca objektive qe aktivet financiare jane zhvleresuar mund te perfshije veshtiresi financiare te konsiderueshme te huamarresit ose emetuesit, mospagesa nga huamarresit, ristrukturimin e nje kredie apo paradhenie nga Banka me kushte qe Banka nuk do t'i kishte konsideruar, tregues qe nje huamarres ose huadhenes po falimenton, zhdukja e nje tregu aktiv per nje leter me vlere, ose te dhena te tjera te dukshme lidhur me nje grup aktivesh te tilla si ndryshimet negative ne statusin e pagesave te huamarresit ose emetuesit ne grup, apo kushtet ekonomike qe lidhen me deshtimin ne banke.

Banka konsideron te dhenat/evidencen per zvleresimin e kredive dhe paradhenive si ne nivel individual ashtu edhe ne nivel grupi. Te gjitha kredite dhe paradheniet individualisht te rendesishme vleresohen per zhvleresim specifik. Ato te cilat nuk jane te zhvleresuara ne menyre specifike, vleresohen ne grup per çdo zhvleresim te ndodhur, por per te cilin nuk jane identifikuar akoma.

Per qellime te vleresimit kolektiv te zhvleresimit, aktivet financiare grupohen ne baze te karakteristikave te ngjashme te rrezikut te kredise (llojin dhe shumen e kredise). Bazuar ne te dhenat historike per secilin prej grupeve llogaritet nje faktor humbjeje. Keta faktore te pritshem te humbjes jane rregulluar me gjykimin e drejtimit nese kushtet aktuale ekonomike dhe te kreditit jane te tilla qe humbjet aktuale te jene me te medha ose me te vogla se tendencat historike, dhe me pas ato jane aplikuar per te vleresuar humbje nga zhvleresimi ne secilin grup. Normat e deshtimit ne pagese, normat e humbjes dhe koha e pritshme e rikuperimeve te ardhshme krahasohen rregullisht kundrejt rezultateve aktuale per tu siguruar qe ato vazhdojne te jene te pershtatshme

Humbja nga zhvleresimi i aktiveve te matura sipas kostos se amortizuar llogaritet si diference midis vleres kontabel dhe vleres aktuale te flukseve monetare te ardhshme te aktualizuara me normen fillestare te interesit efektiv te aktivit.

Nese kushtet e nje aktivi financiar jane rinegociuar ose modifikuar ose nje aktiv financiar ekzistues eshte zevendesuar me nje te ri per shkak te veshtiresive financiare te huamarresit, atehere behet nje vleresim per te percaktuar nese aktivi financiar duhet te çregjistrohet ose jo. Nese flukset monetare te aktivit te rinegociueshem ndryshojne rrenjesisht, atehere te drejtat kontraktuale ndaj flukseve monetare nga aktivi financiar fillestar konsiderohen te skaduara. Ne kete rast aktivi financiar origjinal çregjistrohet, dhe aktivi i ri financiar njihet me vleren e drejte. Humbja nga zhvleresimi matet si me poshte:

- Ne qofte se ristrukturimi i pritur nuk sjell çregjistrim te aktivit ekzistues, flukset e vleresuara te mjeteve monetare qe rrjedhin nga aktivi financiar i modifikuar perfshihen ne matjen e aktivit ekzistues bazuar ne kohen e pritur te tyre dhe te shumave te aktualizuara me normen fillestare te interesit efektiv te aktivit financiar ekzistues.
- Ne qofte se ristrukturimi i pritur rezulton ne çregjistrim te aktivit ekzistues, atehere vlera e pritur e drejte e aktivit te ri trajtohet si fluksi monetar i fundit nga aktivi financiar ekzistues ne kohen e çregjistrimit te tij. Kjo shume eshte e aktualizuar nga data e pritshme e çregjistrimit ne daten e raportimit, duke perdorur normen fillestare te interesit efektiv te aktivit financiar.

Humbjet nga zhvleresimi njihen ne fitim ose humbje dhe pasqyrohen ne nje llogari zbritje perkundrejt huave dhe paradhenieve. Interesi mbi aktivet e zhvleresuara vazhdon te njihet nepermjet skontimeve te pandryshueshme. Kur nje ngjarje qe ndodh pas njohjes se zhvleresimit, shkakton ulje ne humbjen nga zhvleresimi, atehere ulja e humbjes nga zhvleresimi rimerret nepermjet fitimit ose humbjes.

Banka per Biznes Sh.a.
Shenimet per Pasqyrat Financiare
Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015
(Shumat jane ne mije EUR, pervec nese shprehet ndryshe)

3. Politikat e rendesishme te kontabilitetit (vazhdim)

(f) Aktivet financiare dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(vii) Identifikimi dhe matja e zhvleresimit (vazhdim)

Zhvleresimi i huave dhe paradhenieve (vazhdim)

Humbjet njihen ne fitim ose humbje dhe pasqyrohen ne nje llogari zbritese kundrejt huave dhe paradhenieve. Kredite fshihen pasi jane ndermarre masa te arsyeshme te mbledhjeve ne perputhje me politiken e percaktuar te Bankes. Kur nje ngjarje pasuese shkakton ulje te shumes se zhvleresimit, ulja e humbjes nga zhvleresimi rimerret nepermjet fitimit ose humbjes.

Zhvleresimi i aktiveve financiare te vlefshme per shitje

Banka vlereson ne çdo date raportimi nese ka evidence objektive qe nje aktiv financiar ose nje grup aktivesh financiare eshte zhvleresuar. Ne rast te investimeve ne kapital te klasifikuara per shitje, nje renie e ndjeshme ose e shtrire ne vleren e drejte te letrave me vlere nen koston e tij eshte konsideruar ne percaktimin nese aktivet jane zhvleresuar ose jo. Nese ndonje evidence e tille ekziston per asetet financiare per shitje, atehere humbja kumulative e matur si diference midis kostos se blerjes dhe vleres se drejte aktuale, minus ndonje humbje nga zhvleresimi per aktivin financiar e njohur me pare ne fitim ose humbje, eshte hequr nga te ardhurat tjera gjitheperfshirese dhe njihet ne fitim ose humbje. Humbjet nga zhvleresimi te njohura ne fitim ose humbje ne instrumentet e ekuitetit nuk kthehen nepermjet fitimit ose humbjes. Ne qofte se, ne nje periudhe te mepaseshme, vlera e drejte e nje instrumenti borxhi te klasifikuar si i vlefshem per shitje rritet dhe rritja mund te lidhet objektivisht me nje ngjarje qe ndodh pas humbjes nga zhvleresimi eshte njohur ne fitim ose humbje, humbja nga zhvleresimi kthehet nepermjet fitimit ose humbjes.

(g) Paraja dhe ekuivalentet e parase

Paraja dhe ekuivalentet e saj perfshijne monedha dhe kartmonedha ne arke (te gatshme), gjendja ne Banken Qendrore te pakufizuara ne perdorim dhe aktive financiare shume likuide me maturim fillestar deri ne tre muaj te cilat, kane rrezik te pakonsiderueshem ndryshimi te vleres se tyre te drejte, dhe perdoren nga Banka per manaxhimin e angazhimeve afatshkurtra.

Paraja dhe ekuivalentet e saj mbahen me kosto te amortizuar ne pasqyren e pozicionit financiar.

(h) Investimet e mbajtura deri ne maturitet

Letrat me vlere njihen fillimisht me vleren e drejte plus kostot direkte te transaksionit, dhe me pas vleresohen ne varesi te klasifikimit te tyre si te mbajtura deri ne maturim.

Ivestimet e mbajtura deri ne maturim jane aktive jo-derivative financiare me pagesa fikse ose te percaktuara dhe maturitet fiks te cilat Banka ka synimin e qarte dhe aftesine t'i mbaje deri ne maturim, dhe te cilat nuk jane percaktuar permes vleres se drejte nepermjet fitimit ose humbjes ose si te vleshfme per shitje.

Investimet e mbajtura deri ne maturitet mbahen me koston e amortizuar duke perdorur metoden e interesit efektiv, minus ndonje humbje nga zhvleresimi (shih shenimin 3. (f)(vii)). Nje shitje ose riklasifikim i nje sasie te konsiderueshme te investimeve te mbajtura deri ne maturim do te rezultoje ne riklasifikimin e te gjithe investimeve qe mbahen deri ne maturim si te vlefshme per shitje, dhe do te ndalone Banken te klasifikonte investimet si te mbajtura deri ne maturim ne periudhes aktuale dhe per dy vite ne vazhdim. Megjithate, shitjet dhe reklasifikimet ne ndonje prej rrethanave te meposhtme nuk do te shkaktonin nje riklasifikim:

- shitjet ose riklasifikimet qe jane aq afer maturimit sa ndryshimet ne normen e tregut te interesit nuk do te kene nje efekt te ndjeshem ne vleren e drejte te aktivit financiar;
- shitjet ose riklasifikimet pasi Banka ka arketuar kryesisht te gjithe principalin fillestar te aktivit; dhe
- shitjet ose riklasifikimet qe i atribuohen ngjarjeve jo te perseriteshme pertej kontrollit te Bankes qe nuk do te mund te parashikoheshin ne menyre objektive.

Banka per Biznes Sh.a.
Shenimet per Pasqyrat Financiare
Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015
(Shumat jane ne mije EUR, pervec nese shprehet ndryshe)

3. Politikat e rendesishme te kontabilitetit (vazhdim)

(i) Aktivet financiare te vlefshme per shitje

Letrat me vlere njihen fillimisht me vleren e drejte plus kostot direkte te transaksionit.

Investimet e vlefshme per shitje jane investime jo-derivative te cilat jane percaktuar si te vlefshme per shitje ose nuk jane klasifikuar si nje kategori tjeter e aktiveve financiare. Investimet e vlefshme per shitje perbehen nga letrat me vlere te borxhit. Te gjitha investimet e vlefshme per shitje jane matur me vleren e drejte, pas njohjes fillestare.

Te ardhurat nga interesi njihen ne fitim ose humbje duke perdorur metoden e interesit efektiv. Fitimet ose humbjet nga kembimi valutor ne investimet e vlefshme per shitje njihen ne fitim ose humbje. Humbjet nga zhvleresimi njihen ne fitim ose humbje (shih (f)(vii)).

Ndryshime te tjera te vleres se drejte, perveç humbjeve nga zhvleresimi (shih (f)(vii)), njihen ne ATGj dhe paraqiten ne rezerven e vleres se drejte brenda ekuitetit. Kur investimi shitet, fitimi ose humbja e akumuluar ne kapital riklasifikohet ne fitim ose humbje.

(j) Kredite dhe te arketueshmet

Kredite dhe te arketueshmet jane aktive financiare jo-derivative me pagesa fikse ose te percaktueshme, te cilat nuk jane kuotuar ne nje treg aktiv dhe Banka nuk ka per qellim t'i shese meneehere apo ne nje periudhe afatshkurter. Kredite dhe paradheniet bankat dhe klientet jane klasifikuar si kredi dhe te arketueshme.

Kredite dhe paradheniet njihen fillimisht me vleren e drejte plus kostot direkte te transaksionit, dhe me pas vleresohen me koston e amortizuar duke perdorur metoden e interesit efektiv.

(k) Depozitat, huazimet dhe borxhet e varura

Depozitat, huazimet dhe borxhet e varura jane burimet kryesore te Bankes per financim.

Depozitat, huazimet dhe borxhet e varura maten me vleren e drejte minus kostot direkte te transaksionit dhe me pas maten me koston e amortizuar duke perdorur metoden e interesit efektiv.

(l) Pasurite e riposeduara

Paurite e riposeduara jane perfituar nepermjet ekzekutimit te kolateralit per kredite dhe paradheniet me probleme per klientet dhe qe nuk fitojne qira, nuk jane te perdorura nga Banka dhe jane te destinuara per shitje ne nje periudhe kohore te arsyeshme afatshkurter. Pasurite e riposeduara maten sipas vleres me te ulet te kostos dhe vleres neto te realizueshme, dhe çdo zhvleresim njihet ne fitim ose humbje.

(m) Prona dhe pajisjet

(i) Njohja dhe matja

Zerat e prones dhe pajisjeve jane matur sipas kostos minus zhvleresimin e akumuluar dhe ndonje humbje nga demtimet.

Kosto historike perfshin shpenzime qe jane drejtperdrejt te lidhura me blerjen e aktivit. Softueri i blere qe eshte thelbesor per funksionimin e pajisjes perkatese kapitalizohet si pjese e asaj pajisje.

Kur pjese te nje elementi te aktiveve afatgjata kane jetegjatesine e dobishme te ndryshme, ato llogariten si artikuj te veçante (perberesit madhore) te prones dhe pajisjeve.

Çdo fitim ose humbje nga nxjerrja jashte perdorimit te nje zeri te prones dhe pajisjeve (llogaritur si diference midis te ardhurave neto nga shitja dhe vleres kontabel neto te zerit), njihet ne te ardhura te tjera ne fitim ose humbje.

(ii) Kostot pasuese

Kostot pasuese jane kapitalizuar vetem kur vertetohet qe benefitet ekonomike te ardhshme te atij shpenzimi do te rrjedhin ne banke. Riparimet e vazhdueshme dhe mirembajtja jane ngarkuar ne shpenzime ne periudhen qe kane ndodhur.

Banka per Biznes Sh.a.
Shenimet per Pasqyrat Financiare
Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015
(Shumat jane ne mije EUR, pervec nese shprehet ndryshe)

3. Politikat e rendesishme te kontabilitetit (vazhdim)

(m) Pronat dhe pajisjet (vazhdim)

(iii) Zhvleresimi

Zerat e prones dhe pajisjeve zhvleresohen nga data kur ato jane te vlefshme per perdorim. Amortizimi llogaritet per te shlyer koston e artikujve te prones dhe pajisjeve minus vlerat e perllogaritura te mbetura te ketyre aseteve pergjate jetes se parashikuar te perdorimit. Zhvleresimi njihet ne fitim ose humbje.

Zhvleresimi njihet ne fitim ose humbje ne baze lineare pergjate jetes se dobishme te çdo pjese te nje zeri te prones dhe pajisjeve. Jetegjatesia per periudhen aktuale dhe krahasuese eshte si vijon:

	Jetegjatesia
Ndertesa	20 vite
Kompjutera dhe pajisje te lidhura me to	5 vite
Automjete	5 vite
Instalime, mobilje dhe pajisje	5 vite

Permiresimet e objekteve me qera zhvleresohen duke perdorur metoden lineare te amortizimit gjate afatit me te shkurter te qirase dhe te jetes se tyre te dobishme. Jeta e dobishme e permiresimeve ne objektet e marra me qira eshte 5 vjet.

Metodat e zhvleresimit, jetegjatesia e dobishme dhe vlerat e mbetura jane rivleresuar ne daten raportimit dhe rregulluar kur duhet.

(n) Aktive te patrupezuara

Softueret e blera nga Banka jane matur me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe minus ndonje humbje nga zhvleresimi. Shpenzimet e pasuese mbi programet kompjuterike kapitalizohen vetem kur rrisin perfitimet e ardhshme ekonomike te trupezuara ne asetin specifik me te cilin lidhen. Te gjitha shpenzimet e tjera njihen kur ndodhin.

Amortizimi njihet ne fitim ose humbje gjate jetes se dobishme te aktivit, qe nga data qe eshte te vlefshme per perdorim.

Softueri amortizohet duke perdorur metoden lineare gjate jetes se dobishme prej pese vjetesh. Metodat e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen ne çdo date raportimi dhe rregullohen nese eshte e pershtatshme.

(o) Renia ne vlere e aktiveve jo financiare

Vlera kontabel e aktiveve jo-financiare te bankes, perveç aktiveve per tatime te shtyra, rishikohet ne çdo date raportimi per te percaktuar nese ka ndonje tregues per zhvleresim. Nese ka tregues te tille atehere vleresohet vlera e rikuperueshme e aktivit. Nje humbje nga zhvleresimi njihet nese vlera kontabel e nje aktivi ose e njesise gjeneruese te mjeteve monetare te saj e tejkalon shumen e saj te rikuperueshme.

Shuma e rikuperueshme e nje aktivi ose e njesise gjeneruese te parase eshte me e madhja nga vlera e tij ne perdorim dhe vlera e drejte minus kostoja per shitje. Ne vleresimin e vleres ne perdorim, flukset e te hollave te ardhshme te parase jane aktualizuar ne vleren e tyre aktuale duke perdorur nje norme skontimi para taksave qe reflektojne vleresimet aktuale te tregut per vleren ne kohe te parase dhe risqet specifike per aktivin.

Humbjet nga demtimi jane njohur ne fitim apo humbje. Humbja nga renia ne vlere kthehet deri ne ate mase sa vlera kontabel e aktivit nuk tejkalon vleren kontabel qe do te percaktohej duke i zbritur amortizimin, ne qofte se nuk eshte njohur humbja nga zhvleresimi.

(p) Provizionet

Nje provizioni njihet nese si pasoje e nje ngjarje te meparshme, ku Banka ka nje obligim ligjor aktual apo konstruktiv qe mund te vleresohet me saktesi dhe ka mundesi qe nje dalje e te mirave materiale do te kerkohet per te shlyer obligimin. Provizionet percaktohen duke aktualizuar flukset e ardhshme te pritura te aktiveve monetare me nje norme para tatimit e cila reflekton vleresimet aktuale te tregut per vleren e parase ne kohe dhe sipas rastit, me rreziqet specifike te detyrimit. Skontimi i pashmangshem njihet si kosto financiare.

Banka per Biznes Sh.a.
Shenimet per Pasqyrat Financiare
Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015
(Shumat jane ne mije EUR, pervec nese shprehet ndryshe)

3. Politikat e rendesishme te kontabilitetit (vazhdim)

(q) Perfitimet e punonjesve

(i) Planet e percaktuara te kontributeve

Detyrimet per kontributet ne planet e percaktuara te kontributeve njihen si shpenzim ne fitim ose humbje kur ato ndodhin. Banka paguan vetem kontribute per sigurimet shoqerore te detyrueshme qe ofrojne perfitime ne forme te pensioneve per punonjesit me rastin e pensionimit. Autoritetet vendase jane pergjegjese per percaktimin e limitit minimal ligjor te vendosur per pensionet ne Kosove sipas nje plani te percaktuar te kontributeve per pensione.

(ii) Perfitimet afatshkurtra

Detyrimet per perfitimet afatshkurtra te punetoreve maten mbi nje baze te paaktualizuar dhe njihen si shpenzime me momentin e ofrimit te sherbimit. Nje provizion njihet per shumen qe pritet te paguhet sipas nje bonusi afatshkurter ne te holla ose sipas planit per ndarjen e fitimit nese banka ka nje detyrim ligjor aktual ose konstruktiv per te paguar kete vlere si rezultat i sherbimeve ne te kaluaren te ofruara nga punonjesi me ç'rast detyrimi mund te vleresohet me saktesi.

(r) Garancite financiare dhe angazhimet per hua

Garancite financiare jane kontrata qe e detyrojne Banken qe te beje pagesa specifike per te rimbursuar mbajtesin per nje humbje qe lind kur nje debitor specifik nuk paguan ne afat sipas termave te nje instrumenti huadhenes. Angazhimet per hua jane angazhimet e percaktuara per te siguruar kredi sipas termave dhe kushteve te para-percaktuara. Angazhime te tilla financiare regjistrohen ne pasqyren e pozicionit financiar, nese dhe kur ato behen te pagueshme.

(s) Dividentet

Dividendet nga aksionet e zakonshme njihen ne kapital ne periudhen ne te cilen ato jane miratuar nga aksionaret e bankes. Dividendet per vitin qe jane deklaruar pas dates se raportimit jane paraqitur si ngjarje pas perfundimit te periudhes se raportimit.

(t) Standarde te reja, ndryshime dhe interpretime ende te paadoptuara

Nje numer standardesh, ndryshimesh dhe interpretimesh nuk kane qene ende efektive ne fund te vitit te mbyllur me 31 dhjetor 2015 dhe nuk jane aplikuar ne pergatitjen e ketyre pasyrave financiare. Ato qe mund te jene me rendesi per Banken jane paraqitur si me poshte. Banka nuk planifikon t'i adoptoje keto standarde dhe ndryshime me heret.

SNRF 9 Instrumentet Financiare

SNRF 9, publikuar ne korrik 2014, zevendeson udhezimin ekzistues te SNK 39 Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja. SNRF 9 paraqet udhezime te rishikuara per klasifikimin dhe matjen e instrumenteve financiare, duke perfshire nje model te ri te humbjes se pritshme te kredise per llogaritjen e zhvleresimit te aktiveve financiare, dhe kriteret e reja te pergjithshme mbrojtese te kontabilitetit. Standardi gjithashtu jep udhezime per njohjen dhe mos-njohjen e instrumenteve financiare nga SNK 39. SNRF 9 hyn ne fuqi per periudhat e raportimit vjetor qe fillojne ne dhe pas dates 1 janar 2018, duke lejuar dhe aplikimin paraprak.

Banka ka filluar procesin e vleresimit te ndikimit potencial ne pasqyrat e saj financiare qe rezulton nga aplikimi i SNRF 9. Duke pasur parasysh natyren e aktiviteteve te Bankes, ky standard pritet te kete ndikim te rendesishem ne pasqyrat financiare te Bankes.

SNRF 15 Te ardhurat nga kontratat me klientet

SNRF 15 krijon nje strukture gjitheperfshirese per te percaktuar se sa dhe kur e ardhura duhet te njihet. Ky standard zevendeson interpretimet aktuale te njohjes se te ardhurave, duke perfshire SNK 18 Te ardhurat, SNK 11 Kontratat e ndertimit dhe KIRFN 13 Programet e besnikerise se klienteve. SNRF 15 eshte efektiv per raportime vjetore per periudhat nga ose pas 1 janarit 2018, duke lejuar dhe aplikimin paraprak.

Banka po vlereson ndikimin potencial ne pasqyrat e saj financiare nga aplikimi i SNRF 15.

Banka per Biznes Sh.a.
Shenimet per Pasqyrat Financiare
Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015
(Shumat jane ne mije EUR, pervec nese shprehet ndryshe)

3. Politikat e rendesishme te kontabilitetit (vazhdim)

(t) Standarde te reja, ndryshime dhe interpretime ende te paadoptuara (vazhdim)

Standardet e reja apo te ndryshuara si me poshte nuk pritet te kene ndikim te rendesishem ne pasqyrat financiare te Bankes:

Ne fuqi per periudhat raportuese vjetore qe fillojne me ose pas dates 1 janar 2016

SNRF 14 Llogarite e Shtyra per arsye Rregullatore

Kontabiliteti per Blerjet e Interesave ne Operacionet e Perbashketa (Ndryshimet ne SNRF 11)

Qartesimi i Metodave te Pranueshme te Zhvleresimit dhe Amortizimit (Ndryshime ne SNK 16 dhe SNK 38)

Bujqesi: Bimet Prodhuese (Ndryshime ne SNK 16 dhe SNK 41)

Metoda e Kapitalit neto ne Pasqyrat Financiare Individuale (Ndryshimet ne SNK 27)

Permiresimet vjetore ne SNRF-te 2012-2014 – standarde te ndryshme

Njesite Investuese: Zbatimi i Perjashtimit per Konsolidimin (Ndryshimet ne SNRF 10, 12 dhe SNK 28)

Iniciativa per dhenien e informacioneve shpjeguese (Ndryshimet ne SNK 1)

Ne fuqi per periudhat raportuese vjetore qe fillojne me ose pas dates 1 janar 2017

Iniciativa per dhenien e informacioneve shpjeguese (Ndryshime ne SNK 7)

Njohja e Aktiveve Tatimore te Shtyra per Humbjet e Parealizuara (Ndryshimet ne SNK 12)

Ne fuqi per periudhat raportuese vjetore qe fillojne me ose pas dates 1 janar 2019

SNRF 16 Qirate

4. Perdorimi i vleresimeve dhe gjykimeve

Menaxhmenti diskuton me Komitetin e Auditimit zhvillimin, zgjedhjen dhe paraqitjen e politikave kontabel kritike te Bankes dhe zbatimin e tyre, si dhe supozimet e bera ne lidhje me pasigurite e medha te vleresimit. Informacioni ne lidhje me supozimet dhe vleresimet e pasigurive qe kane nje rrezik te rendesishem te rezultojne ne nje rregullim material brenda vitit te ardhshem financiar dhe per gjykimet kritike ne aplikimin e politikave kontabel qe kane efektin me te rendesishem ne shumat e njohura ne pasqyrat financiare te veçanta jane shpalosur me poshte. Keto shenime shpjeguese mbeshtesin komentet mbi menaxhimin e rrezikut financiar (shih shenimin 26).

(a) Zhvleresimi

Aktivet e llogaritura me kosto te amortizuar vleresohen per zhvleresim ne baze te politikave te pershkruara te kontabilitetit 3.(f)(vii).

Banka rishikon portofolin e saj te kredise per te vleresuar zhvleresimin ne baza te rregullta. Ne percaktimin nese nje humbje nga zhvleresimi duhet te regjistrohet ne pasqyren e te ardhurave apo jo, Banka ben gjykime nese ka te dhena qe tregojne se ka nje renie te matshme ne flukset e ardhshme te parase nga portofoli i kredive para se renia mund te identifikohet me nje kredi individuale ne ate portofol. Kjo evidence mund te perfshije te dhena qe tregojne se ka pasur nje ndryshim negativ ne statusin e pagesave te huamarresve ne grup, apo ne kushtet ekonomike kombetare ose lokale qe lidhen me mungesa ne aktivet e Bankes.

Menaxhmenti perdor vleresime te bazuara ne pervojen historike te humbjeve per aktivet me karakteristika te rrezikut te kredise dhe prova objektive te zhvleresimit te ngjashme me ato ne portofolin kur behet caktimi i flukseve te ardhshme te parase. Metodologjia dhe supozimet e perdorura per vleresimin e shumes dhe kohen e flukseve monetare te ardhshme rishikohen rregullisht per te zvogeluar ndonje diference midis vleresimeve te humbjeve dhe pervojes aktuale te humbjes.

Banka percakton se investimet te vlefshme per shitje zhvleresohen kur ka pasur nje renie te konsiderueshme ose te zgjatur ne vleren e drejte nen koston e tyre. Ky percaktim se çfare eshte e rendesishme ose e shtyre kerkon gjykim. Ne marrjen e ketij gjykimi, Banka vlereson ne mesin e faktoreve te tjere, paqendrueshmerine normale ne çmimin e aksionit. Perveç kesaj, zhvleresimi mund te jete i pershtatshem, kur ka prova te perkeqesimit ne shendetin financiar te te investuarit, performances se industrise dhe te sektorit, ndryshimet ne teknologji dhe flukset operative dhe te financimit te mjeteve monetare.

Banka per Biznes Sh.a.
Shenimet per Pasqyrat Financiare
Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015
(Shumat jane ne mije EUR, pervec nese shprehet ndryshe)

4. Perdorimi i vleresimeve dhe gjykimeve (vazhdim)

(b) Vlera neto e realizueshme e pasurive te riposeduara

Banka ka krijuar nje politike ne lidhje me vlerat e drejta te aktiveve te riposeduara te cilat jane duke u matur me koston me te ulet dhe vleren neto te realizueshme. Matja e vleres se drejte perfshin perdorimin e vleresimeve te pavarura te jashteme te prones, nga nje vleresues qe ka kualifikimet e duhura ligjore profesionale, e cila me pas eshte shqyrtuar nga Menaxhmenti i Bankes per inputet e rendesishme jo te dukshme dhe ndonje rregullim i nevojshem per shlyerje.
Banka nuk mban pronat e riposeduara ne pasqyren e pozicionit financiar per periudhe me te gjate se 5 vite. Vlerat e drejta te aktiveve te riposeduara te Bankes jane te kategorizuara ne Nivelin 3 te hierarkise se vleres se drejte.

Teknikat e vleresimit dhe inputet e rendesishme jo te vezhgueshme

Tabela e meposhtme tregon tekniken e vleresimit te perdorur ne matjen e vleres se drejte si dhe perdorimin e inputeve te rendesishme te pavezhgueshme.

Teknikat e vleresimit	Inpute te rendesishme te pavezhgueshme
Reference ne tregun aktual: Modeli i vleresimit perdor çmimet dhe informacione te tjera te gjeneruara nga transaksionet e tregut duke perfshire asetet identike ose te krahasueshme (te ngjashme), detyrimet, ose nje grup te aktiveve dhe pasiveve (p.sh. nje biznes)	Çmimet e tregut jane modifikuar per te pasqyruar: • Nivelin e transaksioneve te tregut, kur aktiviteti i tregut eshte i ulet ose çmimi per nje prone te njejte eshte i veshtire per tu marre • Gjendja specifike e seciles prone (ndertim, pozita etj)

(c) Percaktimi i vlerave te drejta

Percaktimi i vleres se drejte te aktiveve dhe detyrimeve financiare per te cilat nuk ka çmim tregu kerkon perdorimin e teknikave te vleresimit siç pershkruhet ne shenimin 3.(f)(vi). Per instrumentet financiare qe tregtohen rralle dhe kane pak transparence te çmimeve, vlera e drejte eshte me pak objektive, dhe kerkon nivele te ndryshme gjykimi ne varesi te likuiditetit, perqendrimit, pasigurise se faktoreve te tregut, supozime rreth çmimit dhe risqe te tjera qe ndikojne mbi instrumentin specifik. Banka vlereson vleren e drejte duke shfrytezuar hierarkine e meposhtme te metodave:

- Niveli 1: Çmim i kuotuar i tregut ne tregje aktive per instrumentet identike.
- Niveli 2: Metode vleresimi bazuar ne inpute te vleresueshme. Kjo kategori perfshin instrumentet e vleresuara duke shfrytezuar: çmimet e tregut per instrumente te ngashme ne tregjet aktive; çmimet e tregut per instrumente te ngashme ne tregjet me pak aktive; apo teknika tjera te vleresimit ne te cilat te gjithe faktoret materiale ne menyre direkte apo indirekte jane te vezhgueshem nga te dhenat e tregut.
- Niveli 3: Metode vleresimi bazuar ne inpute te rendesishme jo te vezhgueshme. Kjo kategori perfshin te gjithe instrumentet per te cilat teknikat e vleresimit perfshijne faktore qe nuk bazohen ne te dhena te vezhgueshme dhe faktoret e pavezhgueshem kane nje ndikim material ne vleresimin e instrumentit. Kjo kategori perfshin instrumentet qe jane vleresuar ne baze te çmimeve te tregut per instrumente te ngjashme per te cilat rregullime apo gjykime materiale jo te vezhgueshme kerkohen per te reflektuar dallimet mes instrumenteve.

Vleresimi i vleres se drejte eshte shpalosur ne shenimin 5.

5. Paraqitja dhe vleresimi i vleres se drejte

Vleresimet e vlerave reale bazohen ne instrumente financiare ne pasqyren ekzistuese te pozicionit financiar te Bankes pa u perpjekur per te vleresuar vleren e biznesit te pritshem dhe vleren e aktiveve dhe pasiveve qe nuk konsiderohen instrumenta financiare.

Instrumentet financiare - Hierarkia e vleres se drejte

Tabela e meposhtme tregon vleren e drejte te instrumenteve financiare te matura dhe jo te matura me vleren e drejte dhe i analizon ato sipas nivelit te tyre ne hierarkine e vleres se drejte, ne te cilin eshte kategorizuar secila matje me vleren e drejte.

Banka per Biznes Sh.a.
Shenimet per Pasqyrat Financiare
Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015
(Shumat jane ne mije EUR, pervec nese shprehet ndryshe)

5. Paraqitja dhe vleresimi i vleres se drejte (vazhdim)

Instrumentet financiare - Hierarkia e vleres se drejte (vazhdim)

Aktivet	2015		2014	
	Vlera kontabel	Vlera e drejte Niveli 2	Vlera kontabel	Vlera e drejte Niveli 2
Aktivet financiare te matura me vleren e drejte				
Te vlefshme per shitje	10,372	10,372	-	-
Aktive financiare jo te matura sipas vleres se drejte				
Paraja e gatshme dhe ne banka	33,199	33,199	29,431	29,431
Kredi dhe paradhenie per bankave	960	960	1,211	1,211
Investime te mbajtura deri ne maturitet	-	-	7,242	7,244
Kredi dhe paradhenie per klientet	87,025	89,974	74,979	73,222
Aktivet tjera financiare	291	291	459	459
Detyrimet financiare jo te matura sipas vleres se drejte				
Detyrime ndaj klienteve	115,848	116,330	103,003	103,371
Borxhet e varura	1,848	1,842	1,848	1,599
Huamarrje	3,017	3,017	-	-
Detyrimet tjera financiare	651	651	416	416

Vlerat e drejta per aktivet dhe detyrimet financiare te mesiperme jane percaktuar duke perdorur Nivelin 2 te te dhenave te pershkruara me lart.

Llogarite me bankat

Llogarite nga bankat e tjera perfshijne plasmanet dhe llogarite nderbankare. Perderisa kredite, avanset dhe depozitat jane afatshkurter dhe me norma te ndryshueshme, vlera e tyre e drejte eshte konsideruar te jete e barabarte me vleren e tyre kontabel.

Bonot e thesarit

Bonot e thesarit perfshijne bono te emetuara nga Qeveria e Kosoves, te cilat jane blere me qellim per t'i mbajtur deri ne maturim. Vlera e drejte eshte vleresuar duke perdorur nje model te aktualizimit te fluksit te parave bazuar ne nje lakore aktuale te kthimit te pershtatshem per periudhen e mbetur deri ne maturim.

Obligacionet

Obligacionet jane obligacionet e emetuara nga Qeveria e Kosoves, te cilat jane blere me qellim per tu mbajtur deri ne maturim. Çmimet e kuotuara ne tregjet aktive nuk ishin te vlefshme per keto letra me vlere. Megjithate, ka pasur informacione te mjaftueshme te vlefshme per te matur vlerat e drejta te ketyre letrave me vlere ne baze te inputeve te vezhgueshme te tregut.

Kredite dhe paradheniet per klientet

Kur eshte e mundur, vlera e drejte e kredive dhe paradhenieve eshte e bazuar ne transaksionet e vezhgueshme te tregut. Kur transaksionet e vezhgueshme te tregut nuk jane ne dispozicion, vlera e drejte eshte vleresuar duke perdorur metodat e vleresimit, te tilla si teknikat e fluksit monetar te aktualizuar. Teknikat e vleresimit perfshijne humbjet e pritshme te kredise, normat e interesit dhe normat e parapagimit.

Banka per Biznes Sh.a.
Shenimet per Pasqyrat Financiare
Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015
(Shumat jane ne mije EUR, pervec nese shprehet ndryshe)

5. Paraqitja dhe vleresimi i vleres se drejte (vazhdim)

Kredite dhe paradheniet per klientet (vazhdim)

Per te permiresuar saktesine e vleresimit te kredive tregtare dhe te bizneseve te vogla, kredite homogjene grupohen ne portofole me karakteristika te ngjashme.

Portofoli i kredive te Bankes ka nje vlere te drejte te vleresuar afersisht e barabarte me vleren e tij kontabel per shkak te natyres se tyre afatshkurter apo te normave te interesit te cilat perafrojne me normat e tregut. Pjesa me e madhe e portofolit te kredive eshte subjekt i ndryshimit te çmimeve brenda nje viti.

Detyrime ndaj klienteve, huamarrjet dhe borxhet e varura

Vlera e drejte e borxhit te varur, huave dhe detyrimeve ndaj klienteve jane vleresuar duke perdorur teknika te aktualizimit te rrjedhes se parase, duke zbatuar normat qe jane ofruar per depozitat dhe per borxhin e varur me maturitete dhe kushte te ngjashme. Vlera e drejte e depozitave te pagueshme sipas kerkeses eshte shuma e pagueshme ne daten e raportimit.

6. Te ardhurat neto nga interesi

Te ardhurat neto nga interesi perbehen si ne vijim:

	2015	2014
Te ardhurat nga interesi		
Kredi dhe paradhenie per klientet	9,018	8,917
Kredi dhe paradhenie per bankat	2	5
Investimet e mbajtura deri ne maturitet	-	91
Investimet te vlefshme per shitje	153	-
	9,173	**9,013**
Shpenzimet e interesit		
Depozitat nga klientet	(1,466)	(2,373)
Borxhi i varur	(186)	(183)
Huamarrjet	(17)	-
	(1,669)	**(2,556)**
Te ardhurat neto nga interesi	**7,504**	**6,457**

7. Te ardhurat neto nga tarifa dhe komisionet

	2015	2014
Te ardhurat nga tarifat dhe komisionet		
Transferta pagesash dhe transaksione	1,485	1,665
Tarifat e mirembajtjes se llogarive	321	287
Tarifa dhe komisione te tjera	42	47
	1,848	**1,999**
Shpenzimet nga tarifa dhe komisionet		
Tarifat dhe komisionet nga llogarite bankare	(323)	(328)
Tarifat dhe komisionet ne shperndarjen e ndihmave sociale	(69)	(65)
Tarifa dhe komisione te tjera	(22)	(6)
	(414)	**(399)**
Te ardhurat neto nga tarifat dhe komisionet	**1,434**	**1,600**

Banka per Biznes Sh.a.
Shenimet per Pasqyrat Financiare
Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015
(Shumat jane ne mije EUR, pervec nese shprehet ndryshe)

8. Shpenzime te tjera operative

	2015	2014
Shpenzimet e personelit	2,388	2,173
Qira	667	718
Zhvleresimi dhe amortizimi	368	380
Sigurimi dhe siguria fizike	303	324
Sherbimet komunale dhe karburanti	162	171
Riparimet dhe mirembajtja	152	148
Komunikimi	135	141
Konsulenca	87	111
Shpenzimet e procesimit te kartave	131	104
Shpenzimet e marketingut dhe reklamimit	170	91
Shpenzimet e pastrimit	39	54
Materialet per zyre	49	51
Shpenzimet per anetare te Bordit	42	23
Udhetime	12	8
Shpenzimet e tjera	552	296
Gjithsej	**5,257**	**4,793**

Numri i te punesuarve me 31 dhjetor 2015 eshte 288 (2014: 276).

Shpenzimet e personelit perbehen si me poshte:

	2015	2014
Pagat dhe meditjet	2,111	1,946
Kontributi pensional	104	99
Benefitet sekondare	163	122
Kompensime te tjera	10	6
Gjithsej	**2,388**	**2,173**

9. Shpenzimet e tatimit ne fitim

Ngarkesa e tatimit mbi fitim ndryshon nga shuma teorike qe do te lindte duke perdorur normen mesatare te ponderuar te taksave te zbatueshme per fitimet e Bankes si me poshte:

	Norma efektive	2015	Norma efektive	2014
Fitimi para tatimeve		**2,001**		**1,529**
Tatimi me normen tatimore 10%	10%	200	10%	153
Rregullimi nga provizionet e ndryshme per kredite bazuar ne rregulloren e Bankes Qendrore te Kosoves	-	-	(1.11%)	(17)
Rregullimi per zhvleresimet e pasurive te riposeduara	-	-	0.52%	8
Efekti per shpenzimet e pazbritshme tatimore	0.05%	1	0.33%	5
Efekti tatimor i interesit te perllogaritur mbi depozitat me afat	(1.00%)	(20)	(3.47%)	(53)
Shfrytezimi i humbjeve tatimore te mbartura	(9.05%)	(181)	(5.17%)	(79)
Tatimi ne fitim	**-**	**-**	**1.11%**	**17**

Banka per Biznes Sh.a.
Shenimet per Pasqyrat Financiare
Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015
(Shumat jane ne mije EUR, pervec nese shprehet ndryshe)

9. Shpenzimet e tatimit ne fitim (vazhdim)

Tatimi i shtyre eshte llogaritur me normen prej 10%. Aktivet nga te hyrat e shtyra tatimore jane njohur vetem deri ne masen qe realizimi i perfitimit tatimor eshte i mundshem. Me 31 dhjetor 2015, aktivet nga te hyrat e shtyra tatimore, neto ne shumen prej 87 mije Euro (2014: 268 mije Euro) nuk jane njohur si diference neto e perkohshme per shkak te pasigurise qe fitimet e tatueshme te mjaftueshme do te jene te vlefshme per te lejuar qe te shfrytezohen ne dobi te ketij aktivi tatimor te shtyre.

Periudha per bartjen e humbjeve tatimore ne pajtim me Ligjin mbi Tatimin ne Kosove eshte gjashte vite.

Tatimi ne fitim vleresohet me normen 10% (2014:10%) nga te ardhurat e tatueshme. Tabela ne vijim paraqet humbjet e akumuluara tatimore:

	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Humbjet sipas tatimeve te paregjistruara gjate vitit	167	1,160	2,232	(87)	(789)	(1,814)
Humbjet sipas tatimeve te bartura	167	1,327	3,559	3,472	2,683	869

	2014	Levizjet gjate 2015	2015
Humbjet sipas tatimeve te bartura	(2,683)	1,814	(869)
Aktivi tatimor i shtyre me 10%	268	(181)	87
Minus: Humbjet sipas tatimeve te paregjistruara	(268)	181	(87)
Aktivi tatimor i shtyre ne fund te vitit	-	-	-

Levizjet ne detyrimin per tatimin e shtyre paraqiten si ne vijim:

	2014	Levizjet gjate 2015	2015
Provizionet per humbjet e kredive	105	-	105
Detyrimi per tatimin e shtyre ne fund te vitit	**105**	**-**	**105**

10. Paraja e gatshme dhe ne banka

	2015	2014
Paraja e gatshme	6,335	5,421
Paraja ne banka	4,288	3,119
Gjithsej	**10,623**	**8,540**

Paraja e gatshme dhe ekuivalentet e saj perbehen si ne vijim:

	2015	2014
Paraja e gatshme dhe ne banka	10,623	8,540
Shumat e tjera ne BQK (shenimi 11)	13,531	12,912
Gjithsej	**24,154**	**21,452**

11. Gjendja me Banken Qendrore te Kosoves

	2015	2014
Rezervat e detyrueshme	9,045	7,979
Llogari rrjedhese	13,531	12,912
Gjithsej	**22,576**	**20,891**

Banka per Biznes Sh.a.
Shenimet per Pasqyrat Financiare
Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015
(Shumat jane ne mije EUR, pervec nese shprehet ndryshe)

11. Gjendja me Banken Qendrore te Kosoves (vazhdim)

Ne perputhje me kerkesat e BQK-se ne lidhje me rezerven e depozitave per qellime te likuiditetit, Banka duhet te mbaje nje minimum prej 10% te depozitave te klienteve me maturitet deri ne nje vit, si rezerva te detyrueshme. Rezervat e detyrueshme duhet te perfaqesojne instrumente me likuiditet te larte, duke perfshire para te gatshme, llogarite ne BQK, ose ne bankat e tjera ne Kosove, si dhe shumat e mbajtura ne BQK nuk duhet te jete me pak se gjysma e totalit te rezervave. Pasurite me te cilat Banka mund te plotesoje kerkesat e likuiditetit jane depozitat ne Euro me BQK-ne dhe 50% e ekuivalentit ne EUR te parave te gatshme ne valuta lehtesisht te konvertueshme. Depozitat me BQK-ne nuk duhet te jene me pak se 5% e bazes se depozitave te aplikueshme.

12. Kredi dhe paradhenie per bankat

	2015	2014
Llogarite e bllokuara		
Raiffeisen Bank International	960	776
Banca di Cividale	-	435
Gjithsej	**960**	**1,211**

Kredite dhe paradheniet ne banka perfshijne llogarite e bllokuara ne emer te garancive te klienteve.

13. Investime te mbajtura deri ne maturitet

Letrat me vlere dhe bondet qeveritare te mbajtura deri ne maturitet me 31 dhjetor 2014 jane emetuar nga Qeveria e Kosoves dhe jane prezentuar ne Euro. Instrumentat financiare te Qeverise se Kosoves nuk jane te rankuara.

	2015	2014
Letra me vlere	-	6,942
Bonde qeveritare	-	300
Gjithsej (shiko shenimin 14)	**-**	**7,242**

14. Aktive financiare te vlefshme per shitje

	2015	2014
Letra me vlere	5,334	-
Bonde qeveritare	5,038	-
Gjithsej	**10,372**	**-**

Gjate vitit 2015, Banka ka shitur investime te mbajtura deri ne maturim per afer 6,034 mije euro. Si rezultat, i gjithe portofoli i investimeve te mbajtura deri ne maturim u ndryshua dhe u riklasifikua ne aktive financiare te vlefshme per shitje.

15. Kredi dhe paradhenie per klientet

	2015	2014
Kredi dhe paradhenie per klientet	91,380	80,025
Interesi akrual	534	549
Tarifat e shtyra te disbursimit	(474)	(520)
Gjithsej	**91,440**	**80,054**
Humbjet nga zhvleresimet e kredive	(4,415)	(5,075)
Kredite dhe paradheniet neto te klienteve	**87,025**	**74,979**

Banka per Biznes Sh.a.
Shenimet per Pasqyrat Financiare
Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015
(Shumat jane ne mije EUR, pervec nese shprehet ndryshe)

15. Kredi dhe paradhenie per klientet (vazhdim)

Levizjet ne fondin per humbjet e kredive jane si ne vijim:

	2015	2014
Me 1 janar	5,075	4,458
Shpenzimi per humbjet nga kredite	1,584	2,059
Kredite e fshira	(2,244)	(1,442)
Me 31 dhjetor	**4,415**	**5,075**

Me 31 dhjetor 2014, Banka ka tejkaluar kufirin e percaktuar nga BQK-ja per ekspozimin maksimal ndaj kapitalit te klasit te pare ne lidhje me nje klient apo nje grup te klienteve te lidhur per nje rast, per te cilin Banka ka marre aprovim nga BQK-ja deri me 30 qershor 2015. Banka nuk i ka kaluar kufijte e tille me 31 dhjetor 2015.

16. Pasuri te riposeduara

Pasurite e riposeduara jane pasurite e fituara permes ushtrimit te se drejtes mbi hipotekat per mbulimin e kredive dhe paradhenive te klienteve. Banka tenton dhe po ndermerr hapa qe ti shese keto pasuri per nje periudhe afatshkurter te aresyeshme.

	2015	2014
Pasurite e patundshme banesore	572	371
Pasurite e patundshme komerciale	1,008	1,000
Gjithsej	**1,580**	**1,371**
Minus: renia ne vlere	(833)	(528)
Vlera neto kontabel	**747**	**843**

Vlera e drejte e ketyre aseteve eshte percaktuar duke iu referuar vlerave te tregut nga ana e vleresuesit te jashtem te pavarur. Vlerat jane ulur ne varesi te vendndodhjes se tyre, mirembajtjes dhe kushteve dhe rrethanave qe pasqyrojne vonesat e mundshme ne shitjen e tyre dhe gjatesine e kohes per mbajtjen e pasurive.

Levizjet ne zhvleresimin e aktiveve jane si ne vijim:

	2015	2014
Me 1 janar	528	307
Shpenzimi per zhvleresim gjate vitit	305	241
Kthimet nga pakesimet	-	(20)
Me 31 dhjetor	**833**	**528**

17. Aktive te tjera financiare

	2015	2014
Shpenzimet e parapaguara	133	160
Te hyrat e shtyra nga sherbimet bankare	67	28
Tarifat dhe komisionet e shtyra	84	264
Kerkesa te tjera	7	7
Gjithsej	**291**	**459**

Banka per Biznes Sh.a.
Shenimet per Pasqyrat Financiare
Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015
(Shumat jane ne mije EUR, pervec nese shprehet ndryshe)

18. Aktive te tjera

	2015	2014
Shpenzimet e parapaguara	122	65
Aksionet e mbajtura per shitje nga Banka	-	184
Gjithsej	**122**	**249**

Ne vitet e meparshme, Banka ka dhene nje kredi prej 1,800 mije Euro per Getoar-in, nje nga aksionaret e saj. Kredia eshte siguruar me aksionet e Getoar-it ne Banke, me nje vlere nominale totale prej 184 mije Euro. Getoari ka deshtuar qe ta shlyeje kredine dhe ne vitin 2014, ne baze te nje vendimi gjyqesor aksionet jane ekzekutuar nga Banka nepermjet zbatimit te procedures se sigurise mbi kredine. Me 31 dhjetor 2014, keto aksione jane njohur si pjese e kapitalit me nje aktiv perkates te mbajtur per shitje, te perfshira ne aktive te tjera. Ne vitin 2015, aksionet jane blere nga njeri prej aksionareve ekzistues te Bankes.

19. Aktive te patrupezuara

	Programe kompjuterike
Kosto	
Gjendja me 1 Janar 2014	798
Shtesat gjate vitit	7
Gjendja me 31 Dhjetor 2014	**805**
Shtesat gjate vitit	89
Gjendja me 31 Dhjetor 2015	**894**
Amortizimi i akumuluar	
Gjendja me 1 Janar 2014	551
Shpenzimi per vitin	109
Gjendja me 31 Dhjetor 2014	**660**
Shpenzimi per vitin	87
Gjendja me 31 Dhjetor 2015	**747**
Vlera kontabel	
Gjendja me 31 dhjetor 2014	**145**
Gjendja me 31 dhjetor 2015	**147**

Banka per Biznes Sh.a.
Shenime per Pasqyrat Financiare
Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2015
(Shumat jane ne mije EUR, perveç nese shprehet ndryshe)

20. Prona dhe pajisje

	Ndertesat	Permiresim ne objektet me qira	Mobilet, pjeset, dhe pajisjet	Kompjutera dhe pajisjet e lidhura me to	Automjete	Gjithsej
Kosto						
Me 1 janar 2014	**221**	**636**	**610**	**1,196**	**515**	**3,178**
Shtesat gjate vitit	-	29	9	108	13	159
Pakesimet gjate vitit	(112)	(55)	(45)	(123)	(39)	(374)
Me 31 dhjetor 2014	**109**	**610**	**574**	**1,181**	**489**	**2,963**
Shtesat gjate vitit	-	275	101	177	158	711
Pakesimet gjate vitit	-	(111)	(130)	(178)	(50)	(469)
Me 31 dhjetor 2015	**109**	**774**	**545**	**1,180**	**597**	**3,205**
Zhvleresimi i akumuluar						
Me 1 janar 2014	**42**	**520**	**487**	**985**	**304**	**2,338**
Shpenzimi per vitin	4	42	52	97	76	**271**
Pakesimet gjate vitit	(35)	(55)	(44)	(120)	(36)	**(288)**
Me 31 dhjetor 2014	**13**	**507**	**495**	**962**	**344**	**2,321**
Shpenzimi per vitin	2	62	75	84	58	281
Pakesimet gjate vitit	-	(108)	(129)	(173)	(28)	(438)
Me 31 dhjetor 2015	**15**	**461**	**441**	**873**	**374**	**2,164**
Vlera kontabel						
Me 31 dhjetor 2014	**96**	**103**	**79**	**219**	**145**	**642**
Me 31 dhjetor 2015	**94**	**313**	**104**	**307**	**223**	**1,041**

Me 31 dhjetor 2015 Banka nuk ka ndonje prone te deklaruar si peng.

Pronat dhe pajisjet me 31 dhjetor 2015 perfshijne ndertesa me vlere 94 mije Euro (2014: 96 mije Euro) te riposeduara si kolateral dhe qe menaxhmenti i shfrytezon per aktivitetet e perditeshme te Bankes.

Banka per Biznes Sh.a.
Shenime per Pasqyrat Financiare
Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2015
(Shumat jane ne mije EUR, perveç nese shprehet ndryshe)

21. Detyrime ndaj klienteve

	2015	2014
Llogarite rrjedhese	**50,036**	**43,646**
Ne Euro	47,625	41,955
Ne valuta te huaja	2,411	1,691
Depozitat e afatizuara	**65,812**	**59,357**
Ne Euro	65,084	58,878
Ne valuta te huaja	728	479
Gjithsej	**115,848**	**103,003**

22. Detyrime te varura dhe huamarrje

	2015	2014
Detyrime te varura		
BERZH	1,008	1,008
Individet:		
Valon Budima	420	420
Armend Skeja	420	420
	1,848	**1,848**
Huamarrjet		
Kredia nga FEEJ	3,017	-
Gjithsej	**3,017**	-

Borxhet e varura jane dhene nga palet e mesiperme per ti lejuar Bankes te mbaje nivelet minimale te kapitalit rregullator dhe bartin nje norme vjetore interesi prej 10%. Interesi per BERZH eshte i pagueshem ne baza tremujore, ndersa interesi per individet eshte i pagueshem ne baza vjetore. Borxhet e varura jane te pagueshme ne datat e meposhtme:

- Borxhi nga BERZH: 31 korrik 2019
- Borxhi nga individet: 26 dhjetor 2023.

Gjate vitit 2015, Banka ka hyre ne nje marreveshje huaje me FEEJ (Fondi Evropian per Evropen Juglindore) per nje total prej 4,000 mije Euro. Qellimi i kesaj kredie eshte qe te mbeshtese portofolet e kredive per individe private dhe SME. Nje shume prej 1,000 mije Euro ende nuk eshte disbursuar me 31 dhjetor 2015. Huamarrja ka nje norme interesi prej 3.4% ne vit, dhe eshte e pagueshme brenda tre vjetesh. Interesi eshte i pagueshem ne baza tremujore.

Borxhi i varur nga individet nuk ka kushte te veçanta te bashkangjitura me marreveshje. Banka nuk ka qene ne perputhje me konventat e caktuara financiare te bashkengjitura te marreveshjes me BERZH. Me 31 dhjetor 2014, Banka nuk ka qene ne perputhje si me poshte:

- Mbajtja e nje raporti te aktiveve likuide ndaj depozitave 75% ose me shume (2014: njejte);
- Mbajtja e hendekut negativ te likuiditetit ne lidhje me çdo grup maturimi jo me shume se 20% ne çdo kohe (2014: njejte);
- Mbajtja e nje norme te ekspozimit te hapur te kreditimit jo me shume se 12% ;
- Mbajtja e ekspozimit per 10 huamarresit me te medhenj sipas nivelit te kredive te tyre me pjese ne portfolin kreditor jo me shume se 10%.

Banka per Biznes Sh.a.
Shenime per Pasqyrat Financiare
Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2015
(Shumat jane ne mije EUR, perveç nese shprehet ndryshe)

23. Detyrime te tjera dhe provizione

	2015	2014
Pagesat ne tranzit	295	205
Provizionet per leter garancite te leshuara nga Banka	52	71
Te Pagueshme ne emer te Ministrise se Punes dhe Mireqenies Sociale	170	8
Te Pagueshme ne emer te Ministrise se Ekonomise dhe Financave	25	83
Detyrime ndaj furnitoreve	161	120
Provizione tjera	642	-
Gjithsej	**1,345**	**487**

Banka vepron si agjent per transaksionet e kryera ne emer te institucioneve qeveritare me palet e treta. Kjo perfshin pagesat ne emer te Ministrise se Punes dhe Mireqenies Sociale dhe Ministrise se Ekonomise dhe Financave.

Provizionet e tjera perfaqesojne nje provizion te krijuar per çeshtje ligjore kundrejt aksionareve te meparshem te Bankes. Pala e trete ka fituar kontestin gjyqesor gjate vitit 2015, dhe ka shume mundesi qe edhe Gjykata Supreme ta konfirmoje vendimin. Vlera e kontestit ka qene 642 mije Euro dhe e gjithe shuma eshte provizionuar me 31 dhjetor 2015.

24. Kapitali aksionar dhe rezervat

Kapitali aksionar

Ne pajtim me Ligjin nr. 04/L-093 per "Banka, Institucione Microfinanciare dhe Institucione Financiare Jobankare", kapitali aksionar minimal per bankat qe operojne ne Kosove duhet te jete 7 milion Euro.

Me 31 dhjetor 2015 kapitali aksionar i autorizuar ishte i perbere nga 28,530 aksione te zakonshme (2014: 28,530 aksione te zakonshme). Aksionet e zakonshme kane nje vlere nominale prej 394.2 Euro secili (2014: 394.2 Euro). Pronaret e aksioneve te zakonshme kane te drejte te marrin dividende qe deklarohen kohe pas kohe dhe kane te drejten e nje vote per aksion ne mbledhjet e Bankes. Te gjitha aksionet renditen ne menyre te barabarte ne lidhje me mjetet e mbetura te Bankes. Nje permbledhje e struktures se pronesise eshte si vijon:

	2015		2014	
Emri i aksionarit	%	EUR ('000)	%	EUR ('000)
Afrim Govori	21.27	2,392	21.27	2,392
Rrustem Aliaj	17.27	1,942	17.27	1,942
BERZH	10.00	1,125	10.00	1,125
John Xhan Taip	9.91	1,115	9.91	1,115
Mejdi Rexhepi	9.35	1,052	9.35	1,052
Nazmi Viça	6.89	775	8.80	989
Kareman Limani	4.85	545	4.85	545
Banka di Cividale	4.62	520	4.62	520
Ahmet Arifi	2.39	269	2.39	269
Ismet Sylejmani	1.90	214	-	-
BPB (shiko shenimin 18)	-	-	1.63	184
Rasim Gashi	1.54	173	1.54	173
Riza Mikullovci	1.45	163	1.45	163
Te tjere	1.26	141	1.26	141
DMTH shpk	5.17	581	3.27	367
Naser Aliu	0.62	70	0.62	70
Besnik Vrella	0.62	70	0.62	70
Agim Bilalli	0.62	70	0.62	70
Flamur Bryma	0.27	30	0.53	60
Gjithsej	**100.00**	**11,247**	**100.00**	**11,247**

Banka per Biznes Sh.a.
Shenime per Pasqyrat Financiare
Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2015
(Shumat jane ne mije EUR, perveç nese shprehet ndryshe)

24. Kapitali aksionar dhe rezervat (vazhdim)

Rezerva te tjera

Rezervat e tjera jane krijuar qe nga 31 dhjetori 2011 si diference midis humbjes se akumuluar ne perputhje me SNRF dhe BQK te cilat jane fshire me ane te nje reduktimi ne kapitalin aksionar. Si rezultat i kesaj, keto rezerva jane te kufizuara dhe nuk mund te shperndahen.

Rezerva per rivleresim

Gjate vitit 2014, Banka ka vendosur te perfshije ne kategorine e Prones dhe pajisjeve nje ndertese e cila ka qene me pare pasuri e riposeduar. Ndertesa u njoh nga Banka ne prona dhe pajisje me shumen korresponduese ne rezerven e rivleresimit ne kapital.

